



Udhërrëfyesi

i fillestarit për

ndikimin mbi

politikën

në Shqipëri



All copyrights are reserved to Co-PLAN, Institution for Habitat Development

Co-PLAN, Rruga Bylis 12, Kashar, Tiranë
www.co-plan.org
co-plan@co-plan.org

Author: Sibora Dhima

Content Editor: Rudina Toto

Proofreading: Sibora Dhima

Graphic Design: Silvi Jano, Aida Ciro

Publication year: 2012, Tirana, Albania



“Mos e vërë kurrë në dyshim që një grup i vogël qytetarësh të kujdesshëm e të angazhuar mund ta ndryshojë botën.

Në fakt, është e vetmja gjë që ka ndodhur përherë.”

Margaret Mead

TABLE OF CONTENTS



→ 6 Parathënie

→ 8 Ndikimi mbi politikën në botën e sotme

Ndikimi: një perspektivë e gjerë mbi llojet dhe synimin

Skicim i qasjeve ndaj ndikimit mbi politikën

→ 14 Paraqitja e politikës publike

Politika publike: hyrje

Politikat publike dhe ndikimi mbi to: një tipologji e orientuar nga efekti

→ 23 APolitika publike shqiptare në veprim

Aktorët politikë shqiptarë: konteksti legjislativ dhe ekzekutiv

Mjedisi politik shqiptar: konteksti qytetar

→ 46 Ndikimi përmes ciklit politik

Modeli hap pas hapi dhe cikli politik

Përcaktimi i axhendës: si ta bësh të dukshme një çështje

politikës : strukturimi dhe ngritja e konsensusit

Vendimmarrja: ndikimi përmes levave

Zbatimi i politikës: ndikimi mbi pasojat dhe kontrolli i dëmit

Vlerësimi i politikës

→ 57 Cikli i ndikimit mbi politikën dhe mjetet

Cikli i ndikimit mbi politikën si strukturë e nismave ndikuese

Fazat dhe mjetet e cikleve ndikuese mbi politikën

→ 70 Referencat

Parathënie



Udhërrëfyesi i fillestarit për ndikimin mbi politikën është një guidë udhëzuese për nismat për ndikimin mbi politikën. Ekspertë të politikave publike në Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, kanë hartuar këtë udhërrëfyes që synon një shtresë të gjerë lexuesish, si profesionistë ashtu edhe jo profesionistë. Këtu bëjnë pjesë të ashtuquajturat “think tank”, institutet e reja kërkimore, OJQ-të, akademikët, shoqatat, koalicionet apo grupet e interesit, por edhe individë, analistë politikë dhe këshilltarë qeveritarë. E thënë shkurt, çdo individ apo organizatë që dëshiron të ndikojë në procesin politikëbërës në Shqipëri ose në arenën ndërkombëtare, mund ta përdorë këtë udhërrëfyes si pikënisje për të mësuar se si mund ta ngrejë një çështje për debat publik, për të ndikuar mbi politikën aktuale apo për të bashkuar përpjekjet në sjelljen e ndryshimeve të dëshiruara në fushën e vet të veprimit.

Udhërrëfyesi ofron edhe një hyrje të ngjeshur e praktike për procesin e ndërlikuar të politikëbërjes publike në Shqipëri dhe për mënyrat se si mund të përdoret ky ndikim mbi të. Në një kohë kur ka disa udhërrëfyes që synojnë të drejtojnë përdoruesit se si të hartojnë dhe zbatojnë një veprim apo projekt që ka ndikim mbi politikën publike, vlera e shtuar e këtij udhërrëfyesi është se është ndërtuar mbi shembuj shqiptarë të proceseve politike. Kjo është e dobishme sepse ofron një vështrim të plotë të kontekstit kombëtar politik, çka ndihmon përdoruesit të përshtatin përpjekjet dhe strategjitë e tyre me kërkesat kontekstuale shqiptare.

Udhërrëfyesi hapet duke na njohur me këtë ndikim dhe me arenën politike shqiptare. Në kreun e dytë, një strukturë e thjeshtuar teorike jep llojet e ndryshme të politikës publike dhe qasjet e ndikimit që përshtaten me secilin lloj. Kreu tre kufizohet te politikëbërja publike në Shqipëri dhe e shqyrton procesin si nga konteksti institucional (legjislativ dhe ekzekutiv) ashtu edhe nga ai civil. Pas informacionit bazë mbi politikën publike në Shqipëri, aktorët e lidhur me të dhe mjedisin politik, hidhemi te ajo sesi zhvillohen politikat publike. Kreu katër paraqet ciklin politik, një strukturë konceptuale për të kuptuar se si zhvillohen politikat përmes një modeli hap pas hapi dhe ndërthurjet e çdo faze me ndikimin. Së fundi, kreu 5 na njeh me ciklin e ndikimit që mund të përdoret për të planifikuar dhe zbatuar nisma të tilla ndikuese.

Shembujt dhe rastet e studimit luajnë një rol të rëndësishëm në këtë udhërrëfyes. Skenarë dhe qasje të ndryshme ilustrohen me nisma nga arena shqiptare dhe ndërkombëtare politikëbërëse për t'i krijuar lexuesit idenë e sfidave dhe përpjekjeve që nevojiten zakonisht për të arritur ndikimin mbi politikën.

Shpresojmë që “think tank”-et, organizatat e shoqërisë civile, qendrat studimore si dhe individët e grupet vullnetare ta përdorin këtë udhërrëfyes si një hap të parë për ndikimin mbi politikën. Në synimin e tyre për të ndikuar mbi politikëbërjen, këta ndikues çojnë përpara edhe interesat e tyre ndërkohë që kujdesen për përfshirjen aktive të shoqërisë civile shqiptare në vendimet që i japin formë jetës publike.

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, synon ta përmirësojë më tej cilësinë dhe sasinë e kërkimeve të tij lidhur me politikën dhe të rrisë ndikimin mbi politikën të ndryshme në Shqipëri dhe në Ballkanin Perëndimor. ***Udhërrëfyesi i fillestarit për ndikimin mbi politikën*** është i pari i një serie angazhimesh dhe botimesh nga Co-PLAN në përmbytje të këtij objekti dhe për të dhënë ndihmesën e tij për një mjedis demokratik dhe të matur politikëbërës në Shqipëri.

I. Ndikimi mbi politikën në botën e sotme

Fjala “ndikim” i referohet atij veprimi që kërkon ndryshime në gjendjen aktuale të gjërave. Me fjalë të thjeshta, të ndikosh për diçka do të thotë të ngresh një çështje, ta bësh atë të dukshme për publikun dhe të bësh thirrje për veprim duke nxjerrë në pah një rrugë specifike për ta ndryshuar. Kur kërkojmë të shprehim një shqetësim, të rrisim përgjegjshmërinë, të mbledhim fonde apo të ndikojmë drejtpërdrejt mbi procesin politikëbërës, ky ndikim qëndron në zemër të nismave për ndryshim.

Në shumicën e vendeve, politikat publike rregullojnë fusha të ndryshme të jetës publike. Politikat publike vendosin rregullat e lojës dhe shpesh e vetmja rrugë për të siguruar ndryshime reale e të qëndrueshme në shoqëri është të sjellësh ndryshime në politikë. Për këtë arsye, ndikimi zakonisht i referohet çdo lloj veprimtarie nga një person apo organizatë që synon të ndikojë politikat publike duke sjellë ndryshime në një fushë të caktuar. Në këtë udhërrëfyes, i referohemi **ndikimit si një procesi politik nga një individ ose grup, që synon të ndikojë mbi politikën publike.**

o Ndikimi: një perspektivë e gjerë mbi llojet dhe synimin

Ne ushtrojmë ndikim në jetën tonë të përditshme, shpesh pa e kuptuar, që nga bisedat informate e deri te këshillimet ligjore. Megjithatë, ndikimi mund të jetë edhe shumë i organizuar. Këtyre u referohemi si ndikim i pavarur, aktit të bërjes thirrje për ndryshim përmes metodave formale të ndikimit si: thirrjet për demonstrime dhe peticione - ndikimi masiv, organizimi i një fushate lobimi - ndikimi i grupeve të interesit apo botimi i një gazete politike. Meqë ndryshimet arrihen në mënyra nga më të ndryshmet, ka edhe shumë forma ndikimi. Kështu, forma të ndryshme ndikimi paraqesin qasje të ndryshme për të sjellë ndryshime në një shoqëri.

Ky ndikim mund të përpiqet të ndikojë drejtpërdrejt mbi politikëbërësit - ndikimi i drejtpërdrejtë - ose të ndikojë politikëbërësit duke futur zgjedhësit e tyre ta ushtrojnë këtë ndikim - ndikimi i tërthortë. Shembull i mirë i rastit të parë

mund të jetë lobimi i drejtpërdrejtë, i cili synon të ndikojë mbi vendimet e zyrtarëve qeveritarë duke ushtruar tryshinë e grupit përmbi ta. Shembuj të ndikimit të tërthortë mund të jenë lobimi i masave të gjera që përqendrohet te rritja e vetëdijes, veçanërisht në nivelin lokal, ose aktivizmi që synon të nxisë apo parandalojë ndryshime përmes një vargu të gjerë metodash që nga letrat e shkruara, bojkotet, grumbullimet, marshimet në rrugë, grevat, etj.

Ndikimi mund të ndiqet nga kushdo dhe për këdo. Çdo individ apo grup mund të ngrejë shqetësimet e veta - ndikimi vetjak - ose të ndikojë në emër të të tjerëve, për të ndihmuar të tjerët që pikëpamjet, opinionet dhe shqetësimet e tyre të dëgjohen - ndikimi përfaqësues. Në rastin e dytë, ndikim nuk do të thotë të veprosh në emër të individëve apo grupeve që nuk kanë fuqi lidhur me atë që perceptohet se mund të jetë në interesin e tyre më të mirë. Më tepër, ndikuesit janë ata që i mbështesin këto grupe dhe sigurojnë që zëri i tyre të dëgjohet.

Në këtë kuptim, ndikimi mbi politikën vepron edhe në bërjen publike të çështjeve - ndikimi mbi çështjet - apo perspektivave që mund të mos jenë të dukshme për publikun, duke i vendosur ato në axhendën e politikanëve. Ndikimi mbi politikën mund të përdoret për të parandaluar që rezultatet e kërkimeve, perspektivat e ndryshme apo thjesht idetë e mëdha të humbasin mes debateve publike gjithnjë të pafundme. Ai ndihmon nxjerrjen e tyre në dritë në mënyrë të organizuar, si në sytë e publikut, ashtu edhe të politikëbërësve, duke u ofruar grupeve të ndryshme një mundësi për të ndikuar mbi politikat publike. Në këtë mënyrë, ndikimi mbi politikat nuk u shërben vetëm grupeve që nuk kanë forcë, por edhe studiuesit, “think-tank”-et dhe grupimet civile mund at përdorin për të mobilizuar pikëpamjet e gjetjet e tyre, me qëllim që të ndikojnë mbi ndryshimet në politikë.

Duke u mbështetur në përvojën e Co-PLAN, Institutit për Zhvillimin e Habitatit, po përmendim këtu disa shembuj që ilustronë llojet e mësipërme të ndryshme të ushtrimit të ndikimit.

Një rast i lobimit të drejtpërdrejtë është ai i përfaqësuesve nga Co-PLAN dhe shoqëria civile të cilët punuan së bashku për të trajtuar me qeverinë shqiptare në vitin 2003 çështjen e taksimit të OJQ-ve. Në atë kohë, Co-PLAN mori pjesë aktive në krijimin e një organi përfaqësues për më tepër se 80 OJQ, i cili do të bashkërendonte punën mes sektorit jo-fitimprurës dhe atij publik për të mbrojtur interesat e OJQ-ve. Grupi lobi në disa nivele të sistemit vendimmarrës, madje edhe drejtpërdrejt me kryeministrin. Në vitin 2010, për shembull, përfaqësues nga Co-PLAN dhe OJQ të tjera u takuan me kryeministrin për të diskutuar ndryshimet në legjislacionin mbi praktikën e taksimit të OJQ-ve.

Nismat ndikuese të Co-PLAN përfshijnë edhe disa botime politike, si ai i botuar së fundmi mbi zhvillimet rajonale që synon të ndikojë mbi politikën e zhvillimit rajonal në Shqipëri si dhe në politikën mbi rajonalizimin.


Për një rast të ndikimit përfaqësues, duhet të shohim prapa në vitin 2005 kur Co-PLAN përgatiti një platformë për administrimin e territorit e cila merri në diskutim çështje të ndryshme, përfshi atë të legalizimit të ndërtimeve të paligjshme. Përmes kësaj platforme, Co-PLAN ushtroi ndikim te partitë politike mbi dukurinë e këtyre ndërtimeve, duke marrë kështu pjesë aktive në formësimin e ligjit të ri, studimeve mbi informalitetin, procesin e vetëdeklarimit, etj. Në vitet 1995-2005, Co-PLAN punoi drejtpërdrejt me banorët e këtyre zonave për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për t'i njohur ata me proceset e legalizimit dhe formalizimit. Në vitin 1998, zona e parë, ajo e Bathores, u njoh publikisht, çka shënoi një arritje të Co-PLAN për ndikimin lobues të masave të gjera.

Veç këtyre, një rast i lobimit të çështjes ka qenë ai i përpjekjeve të Co-PLAN për të ndërfaqësuar koncepte të reja për zhvillimin e territorit, të cilat baraspeshojnë interesat private dhe publike. Përpjekjet për ta ngritur këtë çështje pranë qeverisë dhe publikut synonin trajtimin e problemeve të infrastrukturës dhe shërbimeve që të çonin pas të formulat e pabalancuara të zhvillimit të tokës që vazhdojnë të përdoren ende sot në Shqipëri nga shumë praktikues zhvillimi dhe fermerë.

o Skicim i qasjeve ndaj ndikimit mbi politikën

Instituti për Zhvillimet e Jashtme jep një mënyrë të dobishme të ilustrimit të qasjeve të ndryshme ndaj ndikimit në doracakun e tij për studiuesit “Mjetet për ndikimin mbi politikën” (Start dhe Hovland 2004). Siç nxirret në pah në këtë doracak, nismat për ndryshim mund të ndjekin linjën e bashkëpunimit apo linjën e kundërvënies. Kjo do të thotë se mund të bëjmë dallim mes organizatave që synojnë ngritjen e konsensusit dhe atyre organizatave që denoncojnë hapur gjendjen e gjërave. Doracaku po ashtu bënte dallim mes argumenteve të mbështetur në provat racionale dhe kërkimet shkencore dhe argumenteve me interesa vlerë apo të mbështetura vetëm në interesat. Kjo do të thotë se nismat për ndryshim mund ta marrin shtysën dhe t'i ndërtojnë argumentet mbi të dhëna konstruktive për të problematizuar një politikë e për të sugjeruar zgjidhje. Por mund të mbështeten edhe thjesht mbi interesat apo vlerat e një grupi të cilave nuk u shërben politika aktuale. Për shembull, “think-tank”-et priren të operojnë duke propozuar ndryshime mbështetur në studimet, kurse strategjitë e aktivizmit shpesh kërkojnë të arrijnë ndryshime përmes trysnisë së grupit dhe kërkojnë më shumë të nxjerrin në pah problemet sesa të ofrojnë zgjidhje (Start dhe Hovland 2004, f. 5). Fondacioni për Shoqërinë e Hapur e ka përshtatur këtë model në udhërrëfyesin e tij “Si t'i bësh me peshë provat e kërkimit” për të paraqitur rolet e ndikimit të llojeve të ndryshme të organizatave (Young dhe Quinn 2012). Ilustrimi i tyre paraqitet më poshtë:

Figura 1: Rolet e ndikimit të llojeve të ndryshme të OJQ-ve (burimi: FSHH 2012)



Siç mund ta shihni në figurë, dy boshtet bëjnë dallimin mes llojeve të ndryshme të nismave sipas qasjes së ndikimit në politikë: bashkëpunuese përballë konfrontuese dhe të mbështetur në prova kundrejt të mbështetur në interesa/vlera.

Për të dhënë një shembull: Greenpeace International e ka ngritur reputacionin e saj mbi aktivizmin e fortë për të ndryshuar qëndrimet dhe sjelljet mbi çështje të lidhura me mjedisin dhe paqen. Në faqen e saj në Internet ajo deklaron: “Ekzistojmë që të tregojmë kriminelët mjedisorë dhe të sfidojmë qeverinë dhe korporatat kur nuk respektojnë mandatin e tyre për të ruajtur mjedisin dhe të ardhmen tonë”. Kjo shpallje ilustron një qasje më tepër konfrontuese të organizatës që i mbështet nismat e saj ndikuese mbi vlera të përcaktuara qartë.

Sigurisht, rrallë qëllon që një organizatë të bjerë në mënyrë të pastër në një kategori. Autorët japin Këshillin Evropian të Marrëdhënieve me Jashtë (ECFR) si shembullin e një organizate nismat ndikuese të së cilës kryqëzohen në disa qasje, siç shihet në Figurën 1. ECFR-ja shpesh përdor fushatën në media për të ushtruar trysni mbi qeveritë, por përpjekjet e saj nuk përfshijnë protestat në rrugë apo peticionet. “Lloji i qasjes së ndikimit që përdor ECFR-ja është më tepër i rrugës së brendshme i mbështetur në prova nga botime, diskutime, konferenca dhe lobime, por ka edhe përmasën e vlerës me ato që i quajnë “vlera evropiane”, të cilat mbizotërojnë në mesazhet e tyre ndikuese” (Young dhe Quinn 2012, f. 29). Siç thotë në shumicën e botimeve të veta, objektivi kryesor udhëheqës i ndikimit të ECFR-së është të kryejë kërkime dhe të nxisë debatin e informuar në gjithë Evropën për zhvillimin e një politike të jashtme evropiane koherente, efikase dhe të mbështetur në vlera.

Për të ilustruar llojin e debatit ku ushtron ndikim kjo “think-tank” mbarë-evropiane, po japim shembullin e një prej publikimeve të saj të diskutuara gjerësisht nga viti 2012, “Periferia e periferisë: Ballkani Perëndimor dhe kriza e euros”, ku shqyrtohen ndikimet e krizës së euros në Ballkanin perëndimor duke theksuar rreziqet e evropianizimit pa shndërrime më të thella (Bechev 2012).

Figura 2: Pjesë nga shkrimi i ECFR-së “Periferia e periferisë”

përmbledhje

Kriza e euros nuk e vrau zgjerimin por po e flak rajonin në rrethin më të jashtëm të një Evrope me shumë shpejtësi - në periferi të periferisë. Me ekonominë e Ballkanit të kapluara nga nivele të ulëta ose negative rritjeje dhe papunësinë që shtohet, ai ka nxjerrë në dritë kufijtë e modelit evropian të rritjes dhe ka minuar rrëfenjën e konvergencës mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Greqia, dikur një nga modelet e rajonit, tani është një paralajmërim i rreziqeve të evropianizimit pa shndërrime të thella. Anëtarësimi në BE është ende populor në Ballkanin Perëndimor, por mjaft shpesh elitat atje i bien melodisë së Evropës, po nuk ndjekin hapat e saj.

Kriza e Euros e përforcon edhe më shumë tundimin që ekzistonte dikur në BE për të ndjekur një qasje “prit të shohim” ndaj Ballkanit Perëndimor. Por qëndrueshmëria në dukje e kësaj status kuoje mund të dalë mashtrim. Në një kohë kur konfliktet e dhunshme të viteve 1990 ka pak të ngjarë të përsëriten, stancioni brenda rajonit e gërryen ndikimin e BE-së dhe nxit konkurrentët. Që ta bëjë zgjerimin të funksionojë e të rifitojë fuqinë e saj të butë, BE-ja duhet ta kalojë vëmendjen nga rrëfenja e mbështetur te siguria te ajo e mbështetur te ekonomia. BE-ja duhet t'i shpërndajë në mënyrë strategjike burimet e saj të pakta, së bashku me aktorë të tjerë intelektualë si FMN-ja, për të shmangur qulljen ekonomike dhe për t'i ardhur në ndihmë rritjes.

Pavarësisht krizës së euros, Bashkimi Evropian vazhdon të shtrihet në Ballkanin perëndimor: në korrik 2013, Kroacia do të bëhet anëtar i 28-të. Por nën sipërfaqe, marrëdhëniet e BE-se me vendet që ndodhen në pragun e saj po ndryshojnë si pasojë e krizës dhe mënyrës sesi po e shndërron kjo e fundit BE-në. Integrimi është thikë me dy presa për Ballkanin Perëndimor: në kohëra të mira, zemra e Evropës eksportonte të mirat e saj drejt periferisë juglindore; por tani, në kohë krize, po eksporton paqëndrueshmëri. Politikëbërësit dhe analistët evropianë me raste e quajnë ende BE-në si kurën për patologjitë e Ballkanit - sikur kriza të mos kishte ndodhur fare. Por e vërteta është se një BE e shpërbërë mund të jetë mallkim për to.

BE-ja sot përballet me atë që Timothy Garton Ash e quan gjendja “keq ta bësh, keq të mos e bësh”: nëse zona euro del nga problemet e veta, çmimi mund të jetë fare mirë kthimi drejt vetvetes dhe mungesë e oreksit për zgjerim; po nuk doli dot, Ballkani do të mbetet atje jashtë, në të ftohtë, me pak ndihmë nga jashtë për modernizim dhe konsolidim demokratik. 1 Sidoqoftë, kriza po e largon rajonin në rrethin më të jashtëm të një Evrope me shumë shpejtësi - në periferi të periferisë. Dalja e Greqisë nga eurozona mund të dërgojë shkundje të forta në gjithë Ballkanin Perëndimor, me të cilin ajo ka zhvilluar tregti të zgjeruar, investime dhe lidhje njerëzore gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit - pikërisht siç kishte shpresuar Brukseli se do të bënte.

II. Paraqitja e politikës publike

“E gjithë jeta e politikës është kaos qëllimesh dhe rastësish. Nuk është aspak çështje zbatimesh të arsyeshme të të ashtuquajturave vendime përmes strategjive të përzgjedhura”.

Edward Clay

Fillestarëve në fushën e ndikimit mbi politikën, procesi i politikës publike mund t'i duket si një sprovë tejet e ngatërruar dhe përfshirja në këtë proces si një sfidë e pamundur. Kjo vjen për shkak të nocioneve tradicionale që e paraqesin politikëbërjen si një proces të strukturuar mirë (linear dhe ciklik) fazash konstruktive planifikimi, hartimi dhe zbatimi. Kjo pikëpamje e paraqet politikëbërjen si një varg procedurash të padepërtueshme dhe shpesh krijon përshtypjen se, po nuk u përfshi dot qysh në fazat e para kur politika ka filluar të hartohet, aktori do të ketë më pas fare pak mundësi të ndikojë në këtë proces.

Megjithatë, mund të jetë më e thjeshtë nga sa duket gjetja e një pike hyrjeje në procesin politikëbërës nëse e ndërton me kujdes strategjinë ndikuese. Mund të ndodhë që një hyrje e vonuar në proces të jetë më e suksesshme, sidomos kur burimet janë të kufizuara dhe ndikuesit arrijnë të përballojnë një veprim të shkurtër, por vendimtar (për shembull, kur fazat paraprake si vlerësimet e fizibilitetit janë të gjata dhe kërkojnë burime të bollshme). Në fakt, siç e thekson edhe citimi i mësipërm, në realitet ndodh shpesh që procesi politik të jetë rezultat i dinamikave dhe ndërveprimeve të shumta që e kapërcejnë modelin e përcaktuar me “faza”. Mbajtja parasyshe e kësaj, si dhe mundësia për të ndikuar mbi politikën në cilëndo fazë, është hapi i parë për këdo ushtrues të ndikimit.

o Politika publike: hyrje

Shkolla të ndryshme të shkencave politike ofrojnë modele të ndryshme që përfaqësojnë karakterin e ndërlikuar të procesit politikëbërës. Është e rëndësishme të theksohet se asnjë nga këta modele nuk është gjithëpërfshirës dhe mënyra se si e sheh realitetin politik varet së tepërmi nga sfondi dhe ontologjia e tyre. Megjithatë, për qëllime praktike të këtij kreu, kemi ofruar përkufizimet e zakonshme të politikës publike nga disa prej teorive më të famshme që shtjellojnë modelet të cilat hedhin dritë mbi realitetet e politikëbërjes. Kjo do të shërbejë si një farë njohurie bazë për fillestarët në ndikimin mbi politikën.

Një nga përkufizimet më praktike të politikës publike mund të shërbejë si fillim i mirë. Anderson (2003) e përkufizon politikën si: **“një varg relativisht të qëndrueshëm, të qëllimshëm veprimesh të ndjekura nga një aktor apo grup aktorësh në shqyrtimin e një problemi apo çështjeje me interes”**. Politikat publike zhvillohen nga organet dhe zyrtarët qeveritarë në përgjigje të disa kërkesave politike. Disa karakteristika të rëndësishme sipas Andersonit (2003) janë renditur më poshtë:

✓ **Politikat publike janë të qëllimshme**, pra ndryshojnë nga sjellja e rastësishme dhe janë të orientuara drejt synimeve. Për shembull, mbështetja për privatizimin e entiteteve që zotëroheshin më parë nga shteti ka qenë një politikë e vazhdueshme e qeverive shqiptare. Rezultatet nga jo politikë janë privatizimet e herëpashershme, si për shembull, privatizimi i sektorit shpërndarës të energjisë në Shqipëri.

✓ **Politikat publike shfaqen si përgjigje ndaj kërkesave politike të bëra nga aktorët**. Këto kërkesa thjesht mund të bëjnë thirrje për veprim ose ta specifikojnë veprimin e dëshiruar. Për shembull, vitet e fundit, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit shpalli si përparësi politike ndërtimin e rrugëve rurale¹. Kjo politikë publike synonte trajtimin e shkëputjes aktuale të bujqve nga tregjet dhe ishte përgjigje ndaj kërkesave të komunave dhe bashkive, si dhe të partnerëve evropianë. Një tjetër shembull është ai i përshtatjes së gjithë strukturës ligjore shqiptare për bujqësinë dhe mjedisin në linjë me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA) dhe kërkesat e BE-së për integrim.

1. Deklaratë e Ministrisë të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Genc Ruli, 25 tetor 2012.

✓ **Politikat publike përfshijnë edhe ato që bëjnë aktualisht qeveritë**, jo vetëm çfarë përfshijnë strategjitë dhe legjislativoni apo çfarë deklarohen zyrtarët se do të bëjnë. Një shembull mund të jetë përvoja shqiptare me të drejtat e pronësisë intelektuale. Në vitin 2005, pas diskutimesh të gjata, qeveria shqiptare kaloi ligjin Nr. 9830, data 28.04.2005, **”Për të drejtën e autorësisë dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”**. Ai thoshte se shteti do të ndiqte një politikë të mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të në veprimtaritë e natyrës krijuese, prodhuese apo tregtare. Megjithatë, vetëm së fundmi kemi filluar të përjetojmë hapa konkretë lidhur me zbatimin e këtij ligji. Vitet e para pas kalimit të ligjit, për shkak të vështirësive në zbatimin e tij, politika e qeverisë në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale njohu vështirësi zbatimi në përputhje me politikën e deklaruar, çka rezultoi më tepër nga mosrregullimi i sektorit dhe këtyre të drejtave. Ajo që po përjetojmë së fundmi është prirur drejt një politike më proaktive në këtë drejtim.

o **Politikat publike dhe ndikimi mbi to: një tipologji e orientuar nga efekti**

Ka lloje të ndryshme politikash publike dhe metodat e qasjes ndaj çdo lloji natyrisht që ndryshojnë mes tyre. Për ndikuesin fillestar, është e rëndësishme të kuptojë se ndikimi është një nismë që kërkon shumë planifikim². Shumica e këtij planifikimi përfshin identifikimin dhe lokalizimin e saktë të politikës mbi të cilën synojmë të ndikojmë. Kjo sepse shumë politika kërkojnë një qasje të menduar mirë që ndikimi të arrijë synimet e tij. Për shembull, mund të kemi të bëjmë me çështje ku ka mungesë të dukshme njohurish dhe aftësish të publiku. Në këtë rast, një qasje ndikuese që nis duke u marrë së pari me hendekun e informacionin ose aftësisë përmes sesioneve paraqitëse dhe trajnuese ka shumë të ngjarë të ketë sukses në tërheqjen e vëmendjes së publikut të interesuar. Anasjelltas, çështje që përfshijnë interesa të përcaktuara mirë por të kundërta mund të kërkojnë një fushatë më agresive siç është lobimi. Në këtë mënyrë, ndikimi mbi një politikë të caktuar kërkon një lloj të caktuar strategjie dhe përcaktim burimesh që mund të mos jenë zgjidhja optimale për një lloj tjetër.

Politikat mund të ndahen sipas sektorëve, për shembull, politika arsimit, sigurie apo shëndetësie; ose sipas pushtetit autoritativ, për shembull, politika legjislativ, gjyqësore apo ekzekutive. Për shembull, politikat në Shqipëri shpesh paraqiten sipas linjave strategjike në formën e strategjive sektoriale.

2. Një nismë ndikimi, njësoj si politikat publike, kalon nëpër disa faza nga identifikimi i çështjes të monitorimit dhe vlerësimi përfundimtar. Mjete të ndryshme përdoren në çdo fazë për qëllime të ndryshme dhe vetë cikli i ndikimit mund të nis në cilëndo fazë të ciklit politik (për më tepër hollësi shih Kreun 5).

Një shembull është Strategjia Sektoriale e Financave Publike 2008-2013 e cila mbulon: (i) politikat makroekonomike dhe fiskale, administrimin e buxhetit publik, administrimin dhe kontrollin financiar; (ii) administrimin e të ardhurave nga taksat; (iii) administrimin e të ardhurave nga doganat. Kjo strategji pasqyron programin e qeverisë, detyrimet e Shqipërisë sipas marrëveshjeve ndërkombëtare si MSA apo NATO, përparësitë në investimet publike si dhe ndihmën e huaj (SSPF 2008).

Duke mbajtur parasysh fokusin tonë te ndryshimi përmes ndikimit, më poshtë kemi zgjedhur një tipologji të orientuar nga efekti të përpunuar nga Theodore Lowi. Lowi (1968) përpunoi katër kategori kryesore të politikës publike - **përbërëse, shpërndarëse, rishpërndarëse dhe rregulluese** - sipas pohimit “politikat bëjnë politikën” i cili synon të tregojë mënyrat e ndryshme me të cilat qeveritë përqipen të kontrollojnë shoqërinë. Pse ka lidhje me ushtrimin e ndikimit kjo gjë? Tipologjia e tij “*i diferencën politikat mbështetur në efektin e tyre mbi shoqërinë dhe marrëdhënien e atyre që janë përfshirë në formimin e tyre*” (Anderson 2011, f. 11) dhe për këtë arsye është thelbësore të identifikohen pikat kryesore hyrëse për të ndikuar mbi politikëbërjen, që është dhe pikënisja për çdo plan ndikimi mbi politikën. I kemi renditur këto kategori më poshtë duke i ilustruar ato në të njëjtën kohë me shembuj dhe me ato që konsiderohen si qasjet më optimale për ndikimin për secilin lloj³.

Politikat përbërëse

Politikat përbërëse (që përfshijnë pjesët përbërëse të qeverisë, për shembull, që përfshijnë përbërjen ose elementët përbërës të qeverisë) u referohen politikave që kanë lidhje me strukturën e qeverisë, rregullat ose procedurat e sjelljes së saj, rregullat që shpërndajnë ose ndajnë pushtetin dhe juridiksionet brenda të cilave mund të hartohen politikat e sotme dhe të ardhme. Kështu, politikat përbërëse kanë të bëjnë edhe me rishpërndarjen e pushtetit dhe juridiksionin mes entiteteve qeverisëse. Në disa vende ato quhen edhe politika “shtetndërtuese”.

Në dhjetor 2005, Këshilli i Ministrave në Shqipëri ngriti formalisht Departamentin e Strategjisë dhe Bashkëpunimit me Donatorët (DSBD) si pjesë integrale të strukturës së tij organizative. Ky ishte një gur i rëndësishëm kilometrik në politikat për modernizim. DSBD-ja kishte si synim të sigurote që planifikimi i fragmentarizuar strategjik dhe proceset buxhetore të qeverisë të kishin lidhje logjike e të administroheshin me efikasitet dhe që ndihma e huaj të drejtohej aty ku ishin përparësitë kombëtare⁴.

3. Për një skemë të hollësishme të këtyre kategorive, mund t'i referoheni një artikulli të shkruar nga Lowi (1972) “*Katër sistemet e politikës, politika dhe zgjedhja*” botuar në Public Administration Review.

4. Faqja në Internet e Këshillit të Ministrave, pjesa për DSBD-në.

Meqë politikat përbërëse përfshijnë edhe çështje procedurale, ndikuesi i ri duhet ta dijë se veçanërisht në sistemet tepër burokratike, ka mjaft raste që përdoren për të shtyrë ose parandaluar veprimet. Po ashtu, këto politika kanë të bëjnë drejtpërdrejt me ndarjen e pushtetit politik dhe, për këtë arsye, janë mjaft të spikatura për aktorët politikë. Për ta ilustruar:

Në vitin 2010, në linjë me zbatimin e Ligjit Nr. 10119, data 23.4.2009, "Për planifikimin e territorit", u krijua një agjenci kombëtare e planifikimit të territorit. Ligji e vendoste këtë agjenci nën mbikëqyrjen e kryeministrit dhe asaj iu veshën shumë përgjegjësi që më parë mbaheshin nga Drejtoria e Planifikimit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit. Por njëkohësisht, një Vendim i Këshillit të Ministrave (VKM) e vendoste atë nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Punëve Publike përsa i përket strukturës administrative dhe buxhetit. Procesi i forcimit të këtij institucioni, thelbësor për reformat politike planifikuese, nisi në vitin 2010 dhe u përball me sfida të shumta. Këto sfida nuk janë vetëm teknike por shpesh politike e të ngritura mbi interesa.

Në përgjithësi, për shkak të ngatërresave të veçanta përsa u përket lidhjeve mes institucioneve, ligjeve dhe burimeve, politikat përbërëse mund të duken të tmerrshme për publikun. Përpjekjet për të ndryshuar këto politika përzihen drejtpërdrejt me struktura të fuqishme ekzistuese dhe ushtrimi i ndikimeve duhet të jetë tepër agresiv ose shumë bindës (mundësisht të dyja bashkë). Për këtë arsye, burimet duhet të drejtohen për nga veprimtaritë lobuese të planifikuara mirë, studimet politike ose, së fundi, te ngritja e një grupi përkrahësish si zgjidhje e fundit.

Studimet politike janë një hap i mirë i parë në këtë drejtim. Kjo fazë ka të bëjë me çuarjen përpara të një alternative, mbështetur në kërkimet dhe ekspertizat e pavarura dhe të hollësishme të cilat do të çojnë në një politikë më të mirë. Pastaj mund të ndërtohet **fushata lobuese** rreth alternativës së ndikimit dhe të bashkojë interesat e aq shumë aktorëve sa të detyrojë kryerjen e ndryshimeve. Sa më të fuqishëm të jenë aktorët që mbështesin një kauzë, aq më shumë mundësi ka një ushtrim ndikimi të sigurojë sukses. **Ngritja e përkrahjes** mund të përdoret për të mobilizuar mbështetës mes elektoratit, të cilët pastaj zgjedhin një përfaqësues i cili do të përmbushë kërkesat e tyre.

Politikat shpërndarëse

Këto politika u shpërndajnë burime, shërbime apo të mira segmenteve të veçanta apo të gjera të popullsisë. Mund të përzgjedhin përfitues shumë specifikë ose mund t'i drejtojnë fondet publike drejt segmenteve më të gjera apo ndaj të mirës së publikut të zakonshëm, duke hamendësuar se popullata si një e tërë do të përfitojë nga kjo politikë.

Shprehje e politikës shpërndarëse ishte Akti i stabilizimit të emergjencës ekonomike, i kaluar nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara në tetor 2008, i njohur si ligji i "shpëtimit". Ai caktoi një shumë prej 700 miliardë dollarësh për të blerë sigurimet e lëna peng që rrezikonin të mos paguheshin dot. Me këtë hap, shteti donte t'i fshinte këto borxhe nga librat e bankave, fondet e kursimeve dhe fondet e pensioneve që i mbanin. Sigurisht, ligji ndihmoi jo vetëm bankat dhe ishte pjesë e një politike të gjerë shtetërore për të zbutur pasojat e krizës financiare si për bankat ashtu edhe për klientët që kishin marrë përsipër kredi të rrezikshme. E parë nga një perspektivë më e gjerë politike, ky ligj nisi një kthesë të rëndësishme në politikat financiare dhe monetare në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare: një dozë e rëndësishme e ndërhyrjes së shtetit u injektua në atë që prej kohësh quhej qasje tepër rregulluese. Debatet vazhdojnë edhe sot e kësaj dite lidhur me atë nëse qeveria duhet të miratonte më tepër rregulla për bankat, sidomos në ato vende ku investimi ka qenë një sektor "laissez-faire" deri para pak vitesh⁵.

Si shembull të politikës shpërndarëse në kontekstin shqiptar që shtrohet në segmente të gjera të popullsisë mund të japim atë të shërbimeve sociale ose politikave shëndetësore të qeverisë shqiptare.

Në Strategjinë për përfshirjen sociale 2007-2013, qeveria shqiptare rriti subvencionet për pagesën e energjisë nga 9% në 36% të çmimit. U deklarua se rreth 270.000 familje në nevojë do të përfitonin nga kjo skemë si dhe ata punëmarrës që fitonin më pak se 35.000 Lek/muaj, por që ishin të punësuarit e vetëm në familjet e tyre dhe të vetmit që përfitonin nga skema (MPÇSSHB 2007). Këto përpjekje ishin pjesë e një politike të uljes së varfërisë që synonin të ofronin një farë lehtësimi për familjet më të varfra në Shqipëri. Sipas Bankës Botërore, pa këto shërbime sociale, niveli i varfërisë d të kishte qenë 11% më i lartë për popullsinë në përgjithësi dhe 20% më i lartë për përfituesit (Banka Botërore 2006, f. 16)⁶.

Përpjekjet për të ndikuar mbi politikat shpërndarëse shpesh lidhen me parimin e drejtësisë në shpërndarje dhe kanë mundësi të përftojnë gjerësisht nga publiku pjesëmarrës ose nga sistemet e besimit në grup lidhur me atë që është vetëm një shpërndarje e pasurisë së vendit. Shumë politika shpërndarëse kanë të bëjnë me atë se si shpërndahen fondet publike, ku investohen, si investohen dhe te ç'pjesë e popullatës kanë shkuar. Meqë këto fonde në pjesën më të madhe përbëhen nga paratë e taksave, ushtruesit e ndikimit mund t'i kërkojnë publikut të mbështesë nisma për përdorimin sa më të mirë të parave të tij (ose që t'u jepet fund nismave që mund të përdorin fondet publike për qëllime të perceptuara si të dëmshme, si lufta apo ndotja).

5. Akti i stabilizimit të emergjencës ekonomike 2008 (Kongresi i SHBA-së).

6. MPÇSSHB (2007) Strategjia për përfshirjen sociale 2007-2013.

Ndikimi mbi buxhetin⁷ është një drejtim interesant, sidomos kur politika përfshin përdorime të gjer atë fondeve publike. Ky lloj ndikimi i referohet një pjesëmarrjeje të shtuar dhe analize të organizatave të shoqërisë civile përsa i përket vlerësimit dhe ndikimit mbi buxhetin dhe vendimet buxhetore. Këto nisma mbështeten në parime kyçe si transparenca, përgjegjshmëria, pjesëmarrja, përshtatshmëria, përparësitë, përparimi dhe drejtësia. Një shembull mund të jetë ai i punës së organizatës së tipit “rojtar” që ndjek rrugën sesi investohen taksat e çdo individi nëpër projekte dhe shërbime. Në shumë vende, përfshi Shqipërinë, taksat mblidhen dhe rishpërndahen për investime të ndryshme. Kështu që është mjaft e vështirë të dish se si përdoren taksat e ndryshme nga qeveria. Për shembull, është e vështirë të thuhet nëse taksa e ndërtesës shkon për përmirësimin e infrastrukturës apo thjesht përdoret për qëllime të tjera. Ndikimet mbi buxhetin shpesh synojnë të adresojnë këto të meta duke informuar qytetarët ose duke shkuar një hap më tej dhe duke u përpjekur të reformojnë sisteme të veçanta⁸.

Politikat rishpërndarëse

Siç duket edhe nga emri, politikat rishpërndarëse kanë të bëjnë me rishpërndarjen e pasurisë (në formën e të ardhurave, pronësive, burimeve, etj) nga disa individë apo grupe te të tjerët. Kjo bëhet përmes mekanizmave të ndryshme. Disa nga debatet më aktive në politikat sociale dhe ekonomike sillen rrotull politikave rishpërndarëse, përmasës së tyre etike dhe pasojave mbi grupe të ndryshme. Meqë politikat rishpërndarëse kanë lidhje me parimet e paanësisë dhe drejtësisë sociale, rishpërndarja shpesh merret si ajo politikë që synon për nga drejtësia ose për nga mbështetja duke u dhënë bashkësive të paprivileguara. Megjithëse kjo është e vërtetë, politikat rishpërndarëse mund të përfshijnë edhe marrjen nga bashkësitë, si, për shembull, shtetëzimi i tokës private.

Taksimi është një nga mekanizmat që qeveritë e përdorin për rishpërndarjen e pasurisë. Shembull i debateve për politikën rishpërndarëse është ai i debatit **taksë e sheshtë apo taksë progresive**. Taksat progresive synojnë të lehtësojnë efektin e taksave mbi njerëzit me aftësi më të ulët paguese dhe e kalojnë këtë efekt në mënyrë jo proporcionale mbi personat me aftësi më të larta paguese. Ky debat po zhvillohet aktualisht në Shqipëri ku forcat politike debatojnë lidhur me atë se cilat grupime duhet ta mbajnë peshën për secilin sistem taksues dhe cili do të ishte efekti mbi rritjen ekonomike.

Këto lloje debatesh politike janë tepër të ndjeshme sepse diskutojnë për marrjen nga disa dhe dhënien disa të tjerëve. Debatet për politikat rishpërndarëse mbështeten mbi pohime që nga ana e tyre qëndrojnë mbi vlera thelbësore (shpesh në përplasje) dhe besime lidhur me atë se si duhen ndërtuar shoqëritë. Për këtë arsye, ndikimet mbi politikën rishpërndarëse mund të ngjallin interesim të fortë në gjirin e publikut.

7. Ndikimi mbi buxhetin siç përkufizohet nga Kurrikula e Përgjegjshmërisë Sociale

8. Për shqyrtimin e ndihmesës në rritje të organizatave të shoqërisë civile në buxhetet publike në vendet në zhvillim, mund t'i referoheni një artikulli nga Krafchik: "A mund të shtojë vlera në vendimmarrjen për buxhetin shoqëria civile: një përshkrim i punës së shoqërisë civile për buxhetin".

Një shembull tjetër i një politike rishpërndarëse tepër të ndjeshme është edhe legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve informate në Shqipëri, që ka të bëjë me rishpërndarjen e tokës. Këto politika merren me zhvillimin e shpejtë të ndërtimeve informate në Shqipëri gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit. Megjithëse dhjetëvjeçarin e fundit informaliteti është pranuar si pengesë për zhvillimin dhe janë ngritur legjislacione apo institucione për t'u marrë me të, debatet vazhdojnë t'i problematizojnë çështjen dhe zgjidhjet e propozuara si të padrejta nga ana shoqërore. Shpesh, legalizimi perceptohet si një proces i subvencionuar nga shoqëria më së shumti për përfitimin e një grupi të kufizuar njerëzish në zonat informate. Është e vështirë t'i paraprih kostove të procesit nën dritën e përfitimeve afatgjata për zhvillimin e vendit.

Cilësitë e veçanta të politikave rishpërndarëse mund të përdoren në dobi të ushtruesit të ndikimit nëse janë përshtatur strategjitë e duhura. Por meqë janë në lojë interesa të forta kur ndryshojnë këto politika, ndikuesi duhet të gjejë grupet e duhura të interesit për të mbështetur kauzën.

Politikat rishpërndarëse janë raste delikate dhe qasja ndikuese duhet të jetë shumë proaktive dhe, njëherësh, e mbështetur nga prova të forta. Një strategji e kombinuar është zgjidhje e mirë në këtë rast.

Strategjitë e komunikimit të përgatitura me kujdes, që ngjallin interesin e publikut, mund të gërshetohen me një **fushatë lobimi** për të siguruar mbështetjen e grupeve të interesit. Ka shumë të ngjarë që të ngjallen debate të ashpra prandaj mund të përdoren edhe **artikuj politikë** për të mbështetur fushatën me kërkime thelbësore. Këto mund të shërbejnë për të artikulluar alternativën të cilën mbron si dhe të jep prova teorike dhe empirike për ta mbështetur.

Politikat rregulluese

Siç e tregon edhe emri, politikat rregulluese përqendrohen mbi sjellje dhe veprimtari rregulluese. Këto politika imponojnë shtrengime, kufizime ose detyrime për individët ose grupet (Anderson 2003). Shumë prej tyre ulin lirinë e aktorëve të ndryshëm duke nxjerrë në pah veprimet e ndaluara ose detyrimet për të vepruar. Një shembull tipik i një fushë të rregulluar gjerësisht është rregullimi i zgjeruar i sjelljeve kriminale.

Një fjalë për të tërhequr vëmendjen këtu mbi dallimin mes legjislacionit apo rregullave dhe politikës që i shërbejnë ato: ndërkohë që rregullat mund të jenë të lehta për t'u dalluar, kjo nuk është përherë e vlefshme për politikën publike. Kështu, theksojmë që politikat e lidhura me rregullimin mund të mos jenë gjithmonë të lehta për t'u identifikuar. Ngaqë

shpesh lidhen me rregullat dhe legjislacionin e shkruar, këto politika prirën të perceptohen si të përkufizuara qartë dhe të identifikueshme me lehtësi. Njësoj si me të gjithë politikën publike, nuk ndodh gjithmonë kështu Për shembull, mungesa e artikullimit qeveritar për rregulla të caktuara për disa sjellje, do me thënë, mungesa e rregullores, mund të jetë shpesh një kurs i qëllimshëm veprimi. Le t'i drejtohem edhe një herë shembullit të ligjit të shpëtimit në Shtetet e Bashkuara:

Ligji i “shpëtimit” shënoi një kthesë në politikën financiare dhe monetare: një dozë e rëndësishme e ndërhyrjes së shtetit u injektua në atë që ishte prej kohësh një politikë tepër çrregulluese.

Me fjalë të tjera, politikën e lidhura me rregullimin mund të kenë natyrë rregulluese ose çrregulluese. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me përpjekje për të formësuar sjellje dhe veprime. Ajo që është thelbësore për praktikuesin fillestar të politikës ose të ushtruesit të ndikimit mbi të, është të jetë në gjendje të identifikojë dhe kapë një politikë jo vetëm nga veprimi i qeverisë, por edhe nga mosveprimi i saj. Shpesh, mungesa e një politike të specifikuar qartë, është vetë politikë. Si shembull të politikës rregulluese në kontekstin shqiptar mund të përmendim çdo lloj ligji të fokusuar te rregullimi i një hapësire të caktuar të jetës publike.

Një shembull i politikave të fundit rregulluese në Shqipëri është politika e rregullimit të sektorit të basteve. Kjo politikë artikullohet në **Ligjin Nr. 10033, data 11.12.2008, Mbi lojërat e fatit, i përmirësuar**, si dhe mbi vendimet pasuese të Këshillit të Ministrave për këtë fushë. Deklaratat e fundit të kryetarit të bashkisë së Tiranës mbi zhvendosjen e veprimtarive të basteve në një zonë të caktuar jashtë kryeqytetit mund të shënojnë një politikë të ardhshme të rregulluar më ngushtë. Megjithatë, deri tani, nuk ka veprime praktike apo legjislacion të ri që tregojnë ndryshim të politikës aktuale.

Për shkak të natyrës dhe qëllimit që kanë, politikën rregulluese ka shumë të ngjarë të artikulojnë në dokumente ligjore dhe zyrtare. Për këtë arsye, mund të jetë shumë rezistuese ndaj ndryshimeve. Le të marrim shembullin e një politike relativisht të re të planifikimit të territorit në Shqipëri.

Megjithëse natyra e saj nuk është vetëm rregulluese, politika territoriale shqiptare synon gjerësisht rregullimin e sjelljes së aktorëve të ndryshëm lidhur me territorin. Këta aktorë përfshijnë zbatuesit e zhvillimit, autoritetet planifikuese shtetërore dhe lokale si dhe qytetarët. Politika synon një grup të gjerë dhe mbulon një sektor të shtrirë me një mori çështjesh. Si përfundim, përfshin një mori rregullash dhe rregulloresh të krijuara përmes VKM-ve dhe direktivave të ndryshme. Një pjesë e madhe e këtyre rregullave është e ndërlikuar sepse ndërfut koncepte të reja mbi administrimin e tokës. Në tre vitet e fundit, që kur u miratua kjo politikë, rezistenca ndaj këtyre rregulloreve mbetet ende e lartë.

Këto politika zakonisht synojnë grupe të veçanta të popullsisë, të cilat preken drejtpërdrejt nga pasojat e rregullimeve. Kështu, nismat e suksesshme ndikuese në fushën e rregullimit zakonisht përqendrohen duke afruar grupet specifike të prekura prej tij.

Ndikimi rregullues shpesh nis duke monitoruar rregullisht veprimtarinë rregulluese të qeverisë. Grupet e interesuara që kryejnë monitorimin, diskutojnë edhe ndikimin mbi legjislacionin ekzistues dhe atë të ri në fusha të ndryshme të jetës publike dhe/ose tema të ndryshme. Mbështetur në këtë veprimtari, përcaktohen dhe sugjerohen ndryshimet, të mbështetura me prova nga monitorimi. Gjetjet mund të botohen si **studime politike** ose artikuj politikë. Pasi të jetë arritur konsensusi i nevojshëm publik, mund të kërkohet ndryshimi në legjislacion duke ndjekur rrugën ligjore (thirrja për komisione parlamentare, referendume) ose përmes lobimit nëse ndryshimi i politikës sjell dobi për grupe të fuqishme interesi.

Tipologjia e paraqitur më lart është një nga tipologjitë e shumta për politikën publike. Në varësi të qëllimit, për ndikuesin mbi politikën publike mund të jetë e dobishme të bëjë dallimin mes politikave thelbësore dhe atyre procedurale (çfarë duhet bërë përballë si duhet bërë dhe nga kush), politikave materiale dhe simbolike (shpërndarje e përfitimeve të prekshme përballë tërheqje ndaj vlerave të përbashkëta, si paqja apo drejtësia sociale), politikave që përfshijnë të mirat kolektive dhe atyre që përfshijnë të mirat private (Anderson 2003), e kështu me radhë. Në varësi të temës, qëllimit dhe publikut të ndikimit, ndryshojnë shumë edhe mundësitë e ndërhyrjes.

Me fitimin e përvojës, praktikuesi i politikës publike ka të ngjarë të zbulojë se kategorizimit teorike dhe përkufizimet shpesh ndërthuren në realitet dhe zgjidhjet model duhen përshtatur e kombinuar shpesh. Ajo që është e rëndësishme për ndikuesin fillestar është të jetë në gjendje të zhvillojë një sy kritik që lejon identifikimin dhe ndarjen e politikave të ndryshme publike si dhe të vështrojë përtej tyre për të zbuluar aktorët, lidhjet e pushteteve dhe mundësitë për ndërhyrje. Kjo do të lehtësojë edhe përvetësimin prej tij të metodologjive të ndikimit për çdo nismë të veçantë.

III. Politika publike shqiptare në veprim

Në këtë pjesë, kemi dhënë një përshkrim të aktorëve që, sipas Kushtetutës, përcaktojnë politikën publike në Shqipëri. Synimi është të njihet lexuesi me strukturën institucionale, procedurat dhe aktorët që përcaktojnë politikëbërjen zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Njëkohësisht, kjo pjesë e nje lexuesin me mjedisin politik në Shqipëri, mjedis ku duhet vepruar për të arritur synimet e ndikimit.

o Aktorët politikë shqiptarë: konteksti legjislativ dhe ekzekutiv

Politika publike përfshin një varg të gjatë sistemesh, mjetesh të ndryshme dhe një shumicë aktorësh. Për këtë arsye, shpesh është e vështirë për praktikuesin fillestar të identifikojë dhe përvijojë një politikë publike të caktuar kur kjo nuk është e artikuluar në një strategji apo ligj specifik. Me grumbullimin e përvojës, je në gjendje të dallosh një politikë specifike duke kombinuar dokumente zyrtare, deklaratat publike, programe partiake dhe shumë shprehje (ndoshta edhe kundërthënëse) të vullnetit politik mbi një çështje të caktuar. Por së pari, legjislativi dhe aktet ekzekutive sipas ligjeve mbeten shprehje të identifikueshme lehtësisht të politikës publike. Është po kaq e vështirë, në mos më tepër, të identifikosh pjesëmarrësit në një proces të dhënë politikëbërës. Aktorët kryesorë si deputetët apo anëtarët e KM-së mund të jenë më të dukshëm, por grupet e interesit, partnerët lobues, agjentët e rrjeteve, etj, mund të jenë shumë më të vështirë për tu dalluar. Kjo përsoset me kalimin e kohës ndërkohë që ushtruesi i ndikimit zgjeron jo vetëm njohuritë por edhe kontaktet e lidhjet e tij.


Në këtë mënyrë, diçka që ndihmon së tepërmi në kapërcimin e këtyre sfidave është një njohuri e zgjeruar e mënyrave zyrtare të vënies në zbatim të politikës në një vend. Duke u njohur me proceset zyrtare dhe aktorët, kemi mundësi që jo vetëm të kuptojmë rrugën ligjore të ndikimit mbi një politikë, por të njohim edhe kush janë aktorët më të fuqishëm dhe si ushtrohet e legjitimohet fuqia e tyre. Ligjet, normat dhe rregullat janë vetëm disa nga shprehjet e politikës publike. Megjithatë, sistemi vendimmarrës legjislativ dhe ekzekutiv përbën një hap të parë të mirë në procesin politikëbërës në çdo sistem të dhënë.

Para se të përshkruajmë procesin nëpër të cilin kalon një politikë dhe aktorët që i japin formë zhvillimit të saj, po japim më poshtë një paraqitje skematike të ndarjes së pushteteve në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi është të tregohet se si janë ndarë përgjegjësitë mes funksioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore duke siguruar edhe pavarësinë e tyre nga njëri-tjetri dhe duke ofruar kështu një sistem kontrollesh e baraspeshash. Pavarësia e këtyre funksioneve jepet edhe në nenin 7 të Kushtetutës, i cili thotë: “Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor”. Veç kësaj, ilustruhet edhe roli i qeverisjes vendore në politikëbërje. Ky rol garantohet nga neni 13 i Kushtetutës, i cili thotë: “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore.”

Kështu, pushteti politik në Republikën e Shqipërisë ndahet mes qeverisjes qendrore (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor) dhe qeverisjes vendore. Që të dyja nivelet luajnë rol në politikëbërje. Me përpjekjet për decentralizim në dhjetëvjeçar

e fundit, një nivel i tretë rajonal qeverisjeje po merr rëndësi, me vazhdimin e përpjekjeve për të forcuar rolin e Qarqeve⁹ në Republikën e Shqipërisë. Pjesa tjetër e kreut shpjegon me hollësi sesi institucionet në skemë përdorin instrumente të ndryshme për të zhvilluar politikat.

Figura 3: Qeverisja dhe politikëbërja në Republikën e Shqipërisë (përpunim i yni)



9. Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, ka botuar një dokument të zgjeruar mbi rolin dhe kompetencat e Qarkut dhe institucioneve të tjera mbështetëse lidhur me zhvillimin rajonal.

Legjislacioni si politikë

Aktet normative, në formën e legjislacionit apo vendimeve zyrtare, janë disa nga shprehjet më të qarta të politikës publike. Aktet normative të Këshillit të Ministrave dhe aktet e organeve drejtuese të institucioneve qendrore janë të zbatueshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre. Aktet ligjore të lëshuara nga Qeveritë Vendorë (QV-të) janë të zbatueshme vetëm brenda juridiksionit territorial të QV-së përkatëse. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 116, ka katër lloje aktesh normative në territorin e Republikës së Shqipërisë:

- a. Kushtetuta
- b. Traktatet e ratifikuara ndërkombëtare
- c. Ligjet
- d. Aktet normative të KM-së.

Ushtrimi i ndikimit ligjor në përgjithësi ka të bëjë me mënyrën e ndryshimit apo shfuqizimit të këtyre akteve. Le t'u hedhim nga një vështrim një e nga një.

a. Kushtetuta

Vetë Kushtetuta është shprehje e politikave kombëtare. Për shembull, neni 10 i Kushtetutës thotë se nuk ka fe zyrtare në Republikën e Shqipërisë. Kjo është shprehje e politikës kombëtare të mungesës së diskriminimit mbi baza fetare dhe e ruajtjes së sekularizmit në institucionet dhe politikat shqiptare. Për të pasur një ide se sa e vështirë është të ndryshohet Kushtetuta, përfytyroni llojin e mbështetjes që do të duhej të arrihej për të ndryshuar sekularizmin dhe politikat e shtetit kundrejt fesë në Shqipëri. Në fakt, siç e përcakton edhe neni 116 i Kushtetutës për hierarkinë e normave, Kushtetuta është e para në linjë, madje edhe përpara traktateve ndërkombëtare. Kështu, Kushtetuta ruan epërsinë ndaj të gjitha akteve të tjera normative.

Megjithatë, ka pasur një numër mendimesh të Kushtetutës dhe ndikuesit fillestarë duhet të familjarizohen me procedurën, të rregulluar me nenin 177 të Kushtetutës: Rishikimi i Kushtetutës. Sipas këtij neni, nisma për mendimin e Kushtetutës i përket jo më pak se një të pestës së deputetëve dhe mendimi duhet miratuar nga jo më pak se dy të tretat e gjithë deputetëve. Me këtë kërkesë, të paktën dy të tretat e deputetëve, projekt-amendimet kushtetuese mund t'i nënshtrohen miratimit me referendum. Ndryshe nga projektet e tjera ligjore, Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë të kthejë projekt-amendimet për rishikim në Parlament.

b. Traktatet e ratifikuara ndërkombëtare

Kushtetuta i ndan traktatet ndërkombëtare në dy kategori kryesore, siç saktësohet në nenin 121:

1. Traktate ndërkombëtare që janë ratifikuar ose denoncuar me ligj në Parlament.
2. Traktate ndërkombëtare që janë nënshkruar nga KM-ja dhe nuk marrin ratifikim me ligj.

Para çdo lloj miratimi, traktati i nënshtrohet shqyrtimit kushtetues. Nëse traktati duhet miratuar por nuk është në linjë me ndonjë nen të kushtetutës, së pari duhet amenduar Kushtetuta. Ushtruesit e ndikimit mund t'i përdorin traktatet ndërkombëtare për të mbështetur kauzën e tyre. Për shembull, nëse një vend është nënshkruar i një konvente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ndikuesit mund ta denoncojnë fuqishëm punën e fëmijëve jo vetëm si çnjerëzore por edhe si shkelje të ligjit ndërkombëtar.

Çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e traktateve ndërkombëtare sigurojnë mbështetje të madhe ndërkombëtare dhe mund të shërbejnë si bazë partneriteti të fortë dhe nismash të përbashkëta mes ndikuesve në vende të ndryshme. Mbështetur në mbrojtjen e konventave ndërkombëtare, ndikuesit mund të synojnë ngritjen e partneritetit me organizata simotra jashtë vendit, të cilat mbrojnë të njëjtat çështje. Kjo shërben si për qëllime informimi por shpesh çon edhe në nisma të suksesshme të përbashkëta.

c. Ligjet

Jo të gjitha politikat publike kërkojnë miratim parlamentar. As janë të gjitha të artikuluar në legjislacion. Megjithatë, reformat kryesore politike dhe i gjithë legjislacioni i ri ka nevojë për miratimin e Parlamentit. Përsa u përket ligjeve, *neni 81* i Kushtetutës thotë se të drejtën për të propozuar ligje në Republikën e Shqipërisë e ka "Këshilli i Ministrave, çdo deputet si dhe 20 mijë zgjedhës".

Legjislacioni i propozuar në formën e projektligjeve rishikohet dhe debatohet në parlament nga Komisionet Parlamentare përgjegjëse për atë fushë dhe/ose nga Komisionet e Posaçme që mund të ngrihen për çështje të veçanta në shqyrtim. Për shembull, çdo projektligj shqyrtohet nga Komisioni Kushtetues për të siguruar përputhshmërinë me Kushtetutën. Mbledhjet e komisioneve parlamentare janë përgjithësisht të hapura për publikun. Shpesh ftohen edhe anëtarët e KM-së, në takime marrin pjesë ekspertë të cilëve mund t'u kërkohej të paraqesin pikëpamjet e tyre. Vendimet në këto

komisione merren me shumicë votash¹⁰. Sipas nenit 77 të Kushtetutës, me kërkesën e një të katërtës së gjithë deputetëve, Parlamenti rezervon të drejtën të ngrejë komisione të posaçme për hetim në fusha të ndryshme. Raporti përfundimtar nuk është i detyrueshëm për gjykatat, por mund t'u dërgohet zyrove të prokurorëve, të cilat i vlerësojnë sipas procedurave ligjore.

Lidhur me miratimin, neni 81 i Kushtetutës rendit disa legjislacione kyçe të cilat mund të miratohen vetëm nga tre të pestat e gjithë deputetëve. Shembuj të tyre janë ligjet për kombësinë, ligjet për gjendjet e jashtëzakonshme ose referendumet. Lidhur me gjithë legjislacionin tjetër, neni 78 i Kushtetutës thotë se Parlamenti i miraton ligjet me shumicë votash kur më shumë se gjysma e deputetëve janë të pranishëm. Nëse miratohet nga Parlamenti, projektligji dërgohet te Presidenti i Republikës për miratim. Presidenti mund ta miratojë apo ta kthejë për rishikim të mëtejshëm. Në faqen vijuese do të gjeni paraqitjen e strukturës organizative të Parlamentit Shqiptar¹¹.

d. Aktet normative të KM-së

Aktet normative të lëshuara nga KM-ja janë:


1. Akte normative që kthehen në ligje me miratimin e Parlamentit (siç specifikohet në nenin 116)
2. Vendime
3. Udhëzime dhe Urdhëresa

Një akt i mëvonshëm mbi një çështje të caktuar mund të shfuqizojë aktet e mëparshme. Për shembull, nëse një pjesë legjislacioni hyn fillimisht në fuqi në 2010-ën, ligji i 2012-ës për të njëjtën temë mund të prekë legjislacionin e mëparshëm duke amenduar disa prej neneve të tij ose duke e shfuqizuar plotësisht legjislacionin e mëparshëm.

10. Sipas nenit 78 të Kushtetutës, Parlamenti i merr vendimet me shumicë votash (shumicë të thjeshtë) me praninë e kërkuar të më tepër se gjysmës së deputetëve, përveç rasteve kur Kushtetuta specifikon kërkesën për "shumicë të cilësuar".

11. Për të qenë të përditësuar me komisionet e posaçme që krijohen, mund t'i referoheni faqes zyrtare në Internet të Parlamentit Shqiptar: <http://www.parlament.al>

Figura 4: Struktura aktuale organizative e Parlamentit Shqiptar (burimi: faqja zyrtare në Internet e Parlamentit Shqiptar, përpunim i vetë atij)



Qasja e ndikimit

Sa më mirë ta njohë ushtruesi i ndikimit procedurën legjislative në vend, aq më të lehtë do ta ketë të gjejë pika hyrjeje në proces dhe të ndikojë në vendim. Në këtë kuptim, identifikimi i kohës së duhur për ndërhyrje dhe aktorët e duhur për të ndikuar janë po aq të rëndësishëm sa edhe metodat e ndikimit. Ka dy mënyra për të ndikuar në procesin politikëbërës përmes ndërhyrjes në procedurën legjislative:

- (i) identifikimi dhe shfrytëzimi i pikave hyrëse në proces kur politika/ligji është ende në diskutim ose
- (ii) mbështetja e përmirësimeve dhe propozimi i legjislacionit të ri.

Për metodën e parë, është e rëndësishme që jesh në gjendje të identifikosh fazat e diskutimit si diskutimet paraprake apo shqyrtimet parlamentare, si të kundërta me pikat vendimmarrëse vendimtare, që janë miratimi parlamentar dhe miratimi nga Presidenti. Projektligjet janë më të lehta për t'u ndryshuar në fazën e diskutimeve, prandaj edhe shumë ndikues i ngrenë pretendimet e tyre me anëtarët e komisioneve përkatëse kur janë ende në proces diskutimi të çështjes. Zgjedhja e metodologjisë së ndikimit varet nga shumë ndryshore. Për shembull, Kërkimi Politik dhe Artikujt Politikë mund të përdoren për të ndikuar diskutimet e ligjit, kurse Lobimi mund të përdoret për të ndikuar procesin e votimit.

Për metodën e dytë, Kushtetuta identifikon tri organe që mund të parashtojnë legjislacion të ri në Republikën e Shqipërisë (siç është përmendur më sipër, KM-ja, deputetët dhe 20.000 qytetarë). Në legjislacionin shqiptar nuk ka hapësirë për propozime nga grupet e interesit apo shoqëria civile drejtpërdrejt në parlament. Megjithatë, me metodat e duhura, mund të rezultojë më e lehtë nga sa duket mbledhja e mbështetjes së 20.000 apo më shumë qytetarëve apo për të bindur një deputet të paraqesë një ligj të ri.

Politikëbërja ekzekutive

Sipas *nenit 95 të Kushtetutës*, KM-ja përbëhet nga kryeministri, zëvendëskryeministri dhe ministrat. Neni 100 specifikon: "Këshilli i Ministrave përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore". Kjo detyrë është në përgjegjësi të kryeministrit (neni 102). KM-ja ka fuqinë ligjore të miratojë akte që propozohen nga kryeministri ose ndonjë ministër. Këto akte janë në formën e rregulloreve dhe urdhëresave të nevojshme për zbatimin e ligjeve të kaluara nga Parlamenti. Në raste gjendjesh të jashtëzakonshme, Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë akte normative me të njëjtën pozitë ligjore si atë të ligjeve. Megjithatë, këto akte normative duhen miratuar nga Parlamenti brenda një periudhe 45 ditore përndryshe shfuqizohen (neni 101).

Politikat shtetërore me zanafillë në degën ekzekutive e kanë origjinën në programet e partive politike. Partitë politike i konceptojnë programet e tyre politike para fushatave zgjedhore. Pas zgjedhjeve, programi politik i partisë fituese apo koalicionit njihet si politikë shtetërore. Brenda 10 ditësh nga caktimi i kryeministrit, programi politik dhe përbërja e MS-së dërgohen në Parlamentin Shqiptar për miratim.

Qasja ndikuese

Kuptimi i dinamikave të fushatës dhe proceseve zgjedhore është thelbësor për të zgjedhur kohën dhe mjetet e duhura për ndikim. Për shembull, nëse identifikohet KM-ja si shënjestër për të ushtruar ndikimin, mund ta fillosh nismën para ose gjatë fushatës. Në përgjithësi, politikat janë më të vëmendshëm gjatë stinës zgjedhore dhe prandaj këshillohet që fushata ndikuese të nisë përpara vitit të zgjedhjeve. Kjo i jep ndikuesit kohë të mjaftueshme për të ndikuar në programet politike të partive të përfshira në garë.

Mjetet të tilla si strategjia komunikuese dhe ngritja e përkrahjes duhen futur në punë sa më herët të jetë e mundur para stinës zgjedhore. Kjo shërben për informimin e publikut dhe për ngritjen e mbështetjes për një kauzë, por ç'është dhe më e rëndësishmja, si levë për negociatën të mëtejshme me politikanët. Gjithnjë është më e lehtë të bindësh një ministër të ardhshëm apo zyrtar qeveritar nëse mund t'u tregosh se kauza jote mbështetet nga publiku, do me thënë nga zgjedhësit. Në fillim të stinës zgjedhore, fushatat lobuese dhe artikujt politikë mund të përdoren për të ndikuar programet politike të partive në garë.

Tradicionalisht, kryetari i degës ekzekutive, kryeministri, është drejtues i partisë që ka siguruar shumicën e votave. Për këtë arsye, veç pushtetit që i vesh kushtetuta, kryeministri ka pushtet të konsiderueshëm për të ndikuar në rrjedhën e politikës shtetërore gjatë mandatit të tij. Kështu, kur vjen puna te miratimi i politikave kombëtare, veprimtaritë lotuese që synojnë shefin e ardhshëm të ekzekutivit i shtojnë mundësitë tuaja për sukses.

Politikat e qeverisjes lokale

Kushtetuta u jep QV-ve në Shqipëri të drejtën e miratimit të politikave dhe rregulloreve lokale. Organet e zgjedhura të QV-ve, këshillat vendorë, kanë pushtet të nxjerrin urdhëresa, që shpesh përfaqësojnë politika specifike lokale. Këshillat vendorë kanë edhe pushtetin e mandatimit të taksave të reja¹² mbi qytetarët e tyre, për aq sa lejon legjislacioni për taksat lokale. Këto politika dhe urdhëresa janë në pajtim me legjislacionin kombëtar në atë sektor dhe/ose me të gjitha aktet administrative dhe kushtetuese që kanë lidhje me to. Me këto mjete ligjore dhe fiskale, QV-të ndikojnë mbi zhvillimin ekonomik, planifikimin e territorit, shërbimet dhe mjedisin. Kështu, pushteti që u jep QV-ve kushtetuta dhe legjislacioni mbi qeverisjen vendore ka ndikim të madh e të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve që jetojnë në juridiksionin territorial të tyre dhe, për këtë arsye, përbëjnë një shënjestër të vlefshme të grupeve ndikuese.

12. Në Shqipëri kjo vlen vetëm për taksat e përkohshme. Taksat e tjera, baza dhe kufijtë e tyre përcaktohen nga ligji dhe QV-të vetëm sa mund t'i administrojnë këto taksat apo, në rastin më të mirë, të ndërrojnë vlerën e tyre brenda kufijve të caktuar nga ligji.

Qasja ndikuese

Përpyekjet ndikuese të përqendruara mbi QV-të kanë të mirat e të këqijat e tyre. Për fillestarët, ndikimi mbi politikën lokale është më i lehtë se ndikimi mbi ato kombëtare, për shkak të madhësisë së popullsisë dhe afërsisë së anëtarëve të këshillit vendor me zgjedhësit. Në këtë kuptim, burimet e kufizuara ndikuese ia dalin të arrijnë përfundime të konsiderueshme. Megjithatë, aftësia e qeverisjes vendore për të miratuar politika në Shqipëri është shpesh e kufizuar nga legjislacioni kombëtar dhe burimet financiare. Sidoqoftë, është një hap i parë i mirë ta trajtohet çështjen me QV-në dhe të shohësh se ç'mund të bëhet në nivel lokal.

Përsa u takon politikave kombëtare, QV-të mund të jenë një agjent i rëndësishëm ndryshimi. Sipas Kushtetutës, neni 113, QV-të mund të përfshihen në nisma për të ngritur çështje lokale me autoritetet përgjegjëse ligjore. Ndikuesit mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe, në bashkëpunim me QV-në, të ngrenë çështje me rëndësi të veçantë për rajone të caktuara me autoritetet qendrore.

Referendumet si mjete për ndryshim

Nenet 150, 151 dhe 152 të Kushtetutës rregullojnë të drejtën e qytetarëve shqiptarë për referendum në Republikën e Shqipërisë. Kushtetuta thotë: “Populli, nëpërmjet 50 mijë shtetasve me të drejtë vote, ka të drejtën e referendumit për shfuqizimin e një ligji, si dhe t’i kërkojë Presidentit të Republikës zhvillimin e referendumit për çështje të një rëndësie të veçantë”. Kjo e drejtë i jepet nga Kushtetuta edhe Parlamentit: “Kuvendi, me propozimin e jo më pak se një së pestës së deputetëve ose me propozimin e Këshillit të Ministrave, mund të vendosë që një çështje ose një projektligj i një rëndësie të veçantë të shtrohet në referendum”. Një shembull referendumi në Republikën e Shqipërisë ishte ai për çështjen e rivendosjes së monarkisë me kthimin e Leka Zogut në vend. Më 29 qershor 1997, për herë të parë pas rënies së komunizmit, në Shqipëri u mbajt një referendum për formën e qeverisjes me alternativat: “Republikë” dhe “Monarki kushtetuese”. Rezultati u shpall më 13 korrik 1997 ku forma e qeverisjes “Republikë” fitoi me 904.359 vota apo 66,7%¹³.

Qasja ndikuese¹⁴

Referendumet ndoshta janë metoda më pak e përdorur për ndërhyrje në sistemin ligjor shqiptar, po kjo nuk do të thotë që ushtruesit e ndikimit ta lënë mënjanë. Sidomos **organizatat e shoqërisë civile** mund ta përdorin referendumin si mjet ndikimi nëse ia dalin të tërheqin aq shumë vëmendjen dhe mbështetjen e gjerë të publikut.

13. Nohlen dhe Stöver 2010.

14. Likmeta 2012

Një shembull i suksesshëm është ai i 64.000 nënshkrimeve të mbledhura nga Aleanca Kundër Importit të Plehrave (AKIP), e cila bëri kërkesë për referendum kundër ligjit për importin e mbetjeve në Shqipëri. Kjo e detyroi qeverinë ta zvogëlonte listën e mbetjeve që mund të importohen nga 56 në 25 lëndë.

o Mjedisi politik shqiptar: konteksti qytetar

Mjedisi politik në një vend është tërësia e aktorëve, marrëdhënieve dhe dinamikave që kanë në vetvete një përmasë politike. Kjo përfshin qeverinë dhe institucionet e saj, legjislacionin, pjesëmarrës privatë e publikë, vendas e të huaj. Këta ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi mbi sistemin politik.

Ky është një përshkrim relativisht i thjeshtë i mjedisit politik ku operojnë politika të ndryshme. Ka shumë konceptualizime të ndryshme të mjedisit politik që vijnë nga shkolla të ndryshme mendimi dhe perspektiva të ndryshme. Në varësi të qëllimit të ndikimit, mund të zgjidhet edhe qasja në mjedisin politik ku një çështje e caktuar shqyrtohet nga kënde të ndryshme. Megjithatë, cilado qoftë qasja teorike, është e rëndësishme që mjedisi politik ku do të shtrihet edhe ndikimi juaj të njihet dhe monitorohet me themel. Kjo sepse ndryshimet në mjedisin politik (për shembull, rreziqet e mundësitë e reja apo reagimet e ndryshme nga individët dhe institucionet që ke marrë në shënjestër) mund ta prekin së tepërmi strategjinë e ndikimit dhe morinë e veprimtarive që mund të keni ndërmend të kryeni.

Në përputhje me synimin tonë për t’ju dhënë një farë informacioni bazë për politikëbërjen shqiptare, ky udhërrëfyes ofron edhe një përshkrim të përgjithshëm të mjedisit politik shqiptar. Ndërkohë që pjesa e mësipërme bënte fjalë për kontekstin institucional dhe legjislativ të politikëbërjes, kjo pjesë këtu merret me aspekte të kulturës politike, faktorëve socio-ekonomikë dhe aktorëve ndihmës në politikëbërjen publike. Megjithëse mjedisi politik përfshin aktorë dhe dinamika të panumërta, kemi zgjedhur këto tri ndryshore sepse ato prekin më së tepërmi ndikimet dhe duhen mbajtur parasysh qysh në fazat e para të planifikimit të strategjisë ndikuese.

Kultura politike përfshin disa nga njohuritë e pashprehura me fjalë që vazhdojnë të ekzistojnë në institucionet shqiptare dhe duhet t’u interesojnë ushtruesve të ardhshëm të ndikimit. Faktorët socio-ekonomikë ofrojnë sfondin e nevojshëm fillestar të Shqipërisë për ata ndikues që nuk janë familjarizuar me vendin tonë. Së fundi, aktorë të tjerë që ndikojnë politikën qeveritare janë përmendur më shkurt. Marrëdhëniet mes institucioneve, kultura politike, faktorët socio-ekonomikë dhe aktorët në sfond duhet t’i ofrojnë ndikuesit fillestar aq njohuri bazë sa ai ta nisë veprimtarinë e tij.

Kultura politike në Shqipëri

Kultura është një term-çadër që përfshin në vetvete besimet, vlerat, sjelljen dhe produktet që janë pjesë e një shoqërie të dhënë apo e një organizate specifike. Kultura politike e një vendi është produkt i drejtpërdrejtë i kulturës së përgjithshme dhe historisë së gjithë vendit; është konteksti në të cilin ndërveprojnë gjithë proceset dhe aktorët. Megjithëse është në zhvillim të pandalshëm, kultura politike e një vendi përcakton modele të rëndësishme dhe shpesh kufizime për politikëbërjen, prandaj duhet mbajtur mirë parasysh kur planifikon strategjitë ndikuese. Kultura është më së shumti rezultat i historisë së një populli. Një analizë e hollësishme e zhvillimit historik të kulturës politike shqiptare i kalon qëllimet e këtij udhërrëfyese, por ndoshta një vështrim i shkurtër i historisë së vonshme mund të ofrojë sfondin e parë për ndikuesin fillestar.

Historia e kohëve të fundit¹⁵

Shqipëria sigurisht që nuk është rasti tipik që të vjen ndërmend kur mendon për vendet në zhvillim. Vendi ka një histori të pazakontë prej 40 vjetësh izolimi pothuajse total nga arena politike ndërkombëtare dhe tregjet globale, periudhë gjatë së cilës ishte një nga diktaturat më shtypëse komuniste në Evropë; historia e saj ishte po aq e shkëputur nga Bashkimi Evropian (BE) sa edhe nga bota në zhvillim. Kur sistemi politik dhe ekonomik u përmbys në vitin 1990, shteti u zotua të lidhej e t'u qëndronte besnik vlerave demokratike dhe ekonomisë së tregut. Ajo që pasoi në vitet në vijim ishte më pak proces demokratizimi e më shumë një periudhë tranzicioni social, ekonomik dhe politik.

Nuk është nevoja të thuhet që ishte e vështirë. Një skemë piramidale e dështuar në 1997-ën bëri që shumë familje shqiptare të humbnin kursimet dhe vendi u zhyt në krizë ekonomike, sociale dhe politike (Jarvis 2000) kurse në vitin 1999, gjatë luftës së Kosovës, vendi ende i brishtë strehoi gati gjysmë milioni shqiptarë të Kosovës si refugjatë të zhvendosur (Kondaj 2002). Arena politike vuante vazhdimisht nga përplasjet mes partive të ndryshme politike lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe akuzat për korrupsion. Pavarësisht këtyre pengesave, qeveritë njëra pas tjetrës ndërmorën hapa vendimtarë për të reformuar sistemin ekonomik, ligjor dhe politik të vendit. Dhjetëvjeçarin e fundit vendi ia ka dalë të stabilizohet dhe është vendosur në rrugën e zhvillimit duke u angazhuar për integrimin evropian.

Shqipëria i nisi negociatat me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA) në vitin 2003, pasi u njoh zyrtarisht si “vend potencialisht kandidat”. MSA-ja u miratua dhe nënshkrua më 12 qershor 2006, duke përbërë një përmbushje të suksesshme të hapit të parë të madh drejt anëtarësimit të plotë në BE (MSA-ja mes Shqipërisë dhe BE-së 2006). Vendi aplikoi për anëtarësim në BE më 28 prill 2009 dhe së fundi përftoi nga regjimi i lëvizjes pa viza me Zonën Shengen, pas një periudhe të gjatë e të lodhshme pengesash mbi lëvizjen e qytetarëve të saj (Këshilli i Bashkimit evropian 2010).

Kritikët citojnë shpesh një hap të munguar në zhvillimin e Shqipërisë: pas rënies së regjimit komunist, shoqëria shqiptare dhe elitat sunduese nuk u përfshinë në një proces analize dhe mësimi nga e shkuara. Ndërkohë që vitet e tranzicionit rridhnin, gabimet e regjimit komunist nuk u përcaktuan kurrë qartë. Megjithëse disa akademikë dhe OJQ u përfshinë në veprimtari që nxirrnin në pah strategjitë dhe metodat e gabuara të së shkuarës, kjo lëvizje nuk përfshiu popullatën e gjerë, së cilës iu desh të përshtatej shpejt me sistemin e ri. Në këtë mënyrë, kultura politike në Shqipëri ende mbart gjurmë të rrugës komuniste, çka ndikon mjaft në politikën publike dhe gjithë proceset e tjera politike. Kulti i udhëheqësit, centralizimi i fortë i pushtetit dhe shkalla e konsiderueshme e mikromenaxhimit në sektorin publik janë shprehje të kësaj dukurie.

Në fakt, e kombinuar me një sistem mjaft feudal, i cili ka shoqëruar Shqipërinë deri në shekullin e 20-të, epoka komuniste çimentoj kultin e udhëheqësit të pranishëm edhe sot në kulturën dhe institucionet shqiptare. Kjo pasqyrohet, mes të tjerash, në përpjekjet për decentralizim në Shqipëri, të cilat nuk i kanë përmbushur ambiciet dhe pritshmëritë e reformës decentralizuese të miratuar në vitin 2000. Ajo që në të shkuarën ishte caktuar si pjesë e politikave qeveritare, sot është bërë normë e nënkuptuar, gati e pakundërshtueshme. Një shembull i qartë i këtyre normave të nënkuptuara është përdorimi i pozicioneve të rëndësishme në institucionet qeveritare si mjete për rritjen e levave politike duke ua ofruar këto pozicione vetëm individëve të besuar. Për shembull, pozicionet e ministrave shpesh shkëmbehen pa marrë shumë parasysh formimin profesional apo përvojën. Duke e përqendruar pushtetin vetëm në duart e përfaqësuesve politikë besnikë, ekspertët dhe teknokratët janë marginalizuar rëndë deri në atë pikë sa janë shtyrë jashtë institucioneve të Shqipërisë.

15. Përmbledhje nga Dhima, S. (2011) Udhëtimi i Shqipërisë në Procesin e Bolonjës: Evropianizimi i politikave të arsimit të lartë dhe roli i bashkësive epistemike [tezë master]

Ndërlikimet për ndikimin

Kultura politike shqiptare mund të jetë tepër sfiduese si për ndikuesit vendas ashtu edhe për ata të huaj dhe për këtë arsye, shumë nisma ndikimi që importojnë modele të gatshme shpesh nuk arrijnë të ndikojnë realisht në terren. Një nga tiparet kryesore problematike për ndikimet e suksesshme është kulti i sipërpërmendur i udhëheqësit ende mbizotërues në qeverisjen dhe vendimmarrjen shqiptare. Mbizotërimi i udhëheqësit, i cili varet nga lidhjet politike, shpesh e minon vendimmarrjen e informuar dhe pengon decentralizimin e pushtetit. Kështu, është mjaft sfiduese për ndikuesit të ndërhyjnë për të informuar procesin vendimmarrës ose për të ndikuar mbi përfundimet.

Në përpjekje për të identifikuar pikat hyrëse në procesin politikëbërës, ndikuesi fillestar i përjeton shumë shpejt personalisht kufizimet që rrjedhin nga kultura politike shqiptare. Shumica e pozicioneve kyçe në institucionet politike shqiptare është e lidhur politikisht me partinë/koalicionin në pushtet. Kështu, njerëzit që kanë fuqi të angazhojnë burimet publike për të arritur disa qëllime ndikuese, në fakt janë më të motivuar për të shtuar levat e tyre politike. Veç kësaj, ka një kufizim thelbësor përsa i përket ekspertizës në sektorin e politikës publike shqiptare. Rrogat e ulëta, politizimi i lartë dhe favoritizmi e nepotizmi i shtuar i kanë shtyrë ekspertët e papolitizuar me përvojë jashtë sektorit publik.

Ndërlikimet për ushtrimin e ndikimit janë të shumta dhe mund të variojnë nga përzgjedhja e kujdesshme e audiencës shënjestër deri te formësimi i mesazhit në një gjuhë të përshtatshme. Për shembull, në ndonjë rast, që mesazhi i ndikuesve të jetë në të njëjtën valë me audiencën shënjestër (funksionarët e mandatar politikisht), ata duhet të mos përdorin gjuhë tepër teknike dhe mund ta paraqesin rastin duke u mëshuar argumenteve politike për funksionarët e përfshirë në të. Për këtë arsye, *fushatat lobuese*, në varësi të gjykimit të ndikuesit, mund të kërkojnë një grumbullim të konsiderueshëm burimesh krahasuar me *studimin politik* të hollësishëm.

Kultura politike ka përmasa të ndryshme të cilat ndikojnë fort në strategjitë ndikuese. Megjithëse shpesh lihet mënjanë, kultura politike duhet llogaritur si faktor i rëndësishëm në çdo nismë ndikuese, sidomos në fazën planifikuese.

Faktorët socio-ekonomikë të Shqipërisë

Çdo ndikues që synon ushtrimin e ndikimit mbi politikat publike, së pari duhet të kuptojë kontekstin socio-ekonomik në të cilin zhvillohen ato. Kjo është sidomos e vërtetë për vendet në tranzicion ku të dhënat statistikore mbi treguesit makro-ekonomikë dhe socialë janë vetëm të pjesshëm. Prandaj po japim këtu një paraqitje të shkurtër të peizazhit socio-ekonomik shqiptar. Dhjetëvjeçarët e trashëgimisë komuniste dhe 20 vitet e fundit të ekonomisë së përzier kanë sjellë në Shqipëri një përzierje dinamike të sipërmarrësve mendjehapur dhe institucioneve qeverisëse në përshtatje, të cilat ndërveprojnë në një arenë relativisht të qëndrueshme faktorësh makro-ekonomikë. Ky mjedis politik jep mjaft hapësira si për ndikuesit vendas ashtu edhe ata të huaj që duan të ndikojnë mbi politikëbërjen publike. Megjithatë, ekzistojnë pabarazi të theksuara sociale dhe ekonomike të cilat çdo ndikues duhet t'i mbajë parasysh. Këto kanë efektin e tyre të fortë mbi çdo ndikim në shkallë lokale apo kombëtare.

Sipas një studimi të kohëve të fundit të PNUD-it mbi pabarazitë rajonale në Shqipëri në kuadrin e projektit “Mbështetje e integruar për decentralizimin”, në 20 vitet e fundit ka pasur zhvendosje të vazhdueshme të popullsisë drejt Tiranës (PNUD 2010). Veç ndryshimit të peizazhit urban, lëvizjet e popullsisë kanë ndryshuar thellë edhe dinamikat sociale dhe ekonomike të gjithë shoqërisë. “Studimi “Pabarazitë rajonale në Shqipëri” arrin në përfundimin se vitet e fundit lëvizjet e popullsisë drejt Tiranës e kanë kaluar kulmin dhe tani po ulen. Ka mundësi që, gjatë pesë viteve të fundit, shqiptarët të nisin të lëvizin drejt qendrave të tjera urbane.

Mbështetur në nivelin e varfërisë, mundësisë për kujdes shëndetësor dhe shërbime arsimore, studimi vlerëson Kohezionin Social, ku është identifikuar një ndarje përgjatë barrierave natyrore (bregdet-qendër-male) dhe mes qarqeve (PNUD 2010):

- **Tirana** – e vendosur më mirë, me një numër të vogël njerëzish nën kufirin e varfërisë dhe një përqindje relativisht të ulët familjesh që varen nga ndihma sociale, pjesëmarrje të lartë në arsimin e mesëm, qasje më të lehtë ndaj qendrave të kujdesit shëndetësor dhe nivele shumë të ulëta vdekshmërie foshnjore, megjithëse ka numër të pamjaftueshëm mësuesish, ndoshta edhe shkollash e spitalësh si pasojë e rritjes së lartë të popullsisë;
- **Kukës, Dibër, Lezhë, Shkodër, and additionally Berat** – worst situation with high incidence of poverty and wide reliance on social assistance (21% of families in Berat and Lezhë up to 71% in Kukës), relatively good availability of basic education and health facilities due to decreased total population;

- **Qarqet e mbetura** – gjendje e përzier përse i përket kohezionit social me ndryshime të ndryshme e jo të njëanshme, me dallime të forta brenda qarkut sipas ndarjeve gjeografike (fusha apo male) dhe ekonomike (urbane apo rurale).

Lidhur me zhvillimin ekonomik, studimi identifikon sërish në Shqipëri disa ndarje mes qarqeve sipas barrierave natyrore (bregdet-qendër-male). Rënditja ekonomike e qarqeve ka formën në vijim (PNUD 2010):

- **Tirana – qendra kombëtare e rritjes ekonomike** - PKB për frymë më të lartë, strukturë ekonomike të fortë me punësim të lartë në sektorin jo-bujqësor, e njëjta gjë vlen për numrin e sipërmarrjeve aktive dhe të krijuara rishtas dhe për ndërmarrjet e huaja, si dhe kreditimin e biznesit.
- **Durrësi dhe Vlora – spolet e dyta të zhvillimit** – polet e dyta të zhvillimit - tregues të lartë ekonomikë, më të ulët se të Tiranës por në mënyrë domethënëse më të larta se të qarqeve të tjera [...] Durrësi duket si më i favorizuar për shkak të afërsisë me Tiranën, bashkë me të cilën përbën “motorin” ekonomik të vendit (së bashku gjenerojnë gati gjysmën e totalit të PKB-së).
- **Dibra, Kukësi - performanca më e keqe ekonomike** - pothuajse njëtrajtësisht të dobët në të gjithë treguesit (me rezerva përse i përket gjendjes së papunësisë së regjistruar).
- **Qarqet e tjera – performancë e përzier ekonomike** – Lezha, Shkodra dhe Berati konsiderohen si të fundit e grupit.

Treguesit socialë të lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me nivelin e veprimtarisë ekonomike në qarqet përkatëse. Sipas studimit, në 2009-ën Tirana jepte 37,9% të PKB-së ndërkohë që përqindja totale e gjithë PKB-së në rajonet me performancë më të dobët ishte 15.1% (PNUD 2010). Natyrisht, në shumicën e rajoneve të zhvilluara të Shqipërisë shohim jo vetëm nivele më të larta të veprimtarisë ekonomike, por edhe një përqindje më të lartë të punësimit në sektorët më produktivë. Me kalimin e viteve, struktura e ekonomisë shqiptare ka ndryshuar, me sektorët publik dhe bujqësor që kanë humbur terren ndaj sektorëve privat dhe jo-bujqësor. Këto ndryshime strukturore reflektohen edhe në ndryshimin e shifrave të punësimit përgjatë viteve. Për shembull, vëzhgimet e INSTAT-it tregojnë se dhjetëvjeçarit të fundit, punësimi në sektorët publik dhe bujqësor është tkurrur në mënyrë të vazhdueshme duke i lëshuar terren sektorit privat jo-bujqësor.

Table 1: Employment in Albania by Sector (source: UNDP 2010)

Vitet	Sektori Publik	Privat jo Bujqësor	Privat Bujqësor	Totali
2001	20,5 %	22,3 %	57,2 %	100 %
2008	18,1 %	37,8 %	44,2 %	100 %
2009	16,6 %	39,8 %	43,7 %	100 %

Tregues të tjerë të INSTAT-it tregojnë se ekonomia shqiptare mbizotërohet nga ndërmarrjet me 20 apo më shumë punonjës. Megjithatë, në vitin 2009, gati 92% e të gjitha ndërmarrjeve ishin shumë të vogla me 1-4 punonjës kurse ndërmarrjet publike vazhdonin të kishin ndikim të fortë (INSTAT 2009). Në vitin 2012, tregtia me vendet e BE-së përbënte 64%. Partnerët kryesorë tregtarë mbeten Italia dhe Greqia. Tregtia me Italinë qëndron në nivelin 35,5% dhe me Greqinë në 10,6% (INSTAT 2012).

Për shkak të së kaluarës shtetërore, politikanët shihen nga publiku si të veshur me fuqi të konsiderueshme dhe, për arsye praktike, shpesh përfshihen në marrëdhënie të dyshimta me biznesin e madh. Gjatë viteve 1990, mes zbrazëtisë institucionale dhe ligjore, kompanitë tregtare i përdornin lidhjet me zyrtarët e doganave për të importuar produktet e tyre me taksë të ulëta. Korrupsioni i zyrtarëve publikë nga bizneset u rrit së tepërmi. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, korrupsioni gjatë procedurave tenderuese publike (“tenderëve”) ishte po ashtu një shqetësim i madh me raste biznesesh që ndikonin mbi zyrtarët publikë. Privatizimi i aseteve publike së fundi është përfshirë në debate për shkak të ankesave për parregullsi. Megjithëse janë bërë përpjekje për të luftuar korrupsionin, duket se ai është ende një problem i përhapur i denoncuar shpesh nga mediat.

Ndërlikimet për ndikimin

Njësoj si çdo nismë tjetër, ndikimet kërkojnë shumë planifikim dhe mbledhja e informacioneve konstruktive mbi treguesit socio-ekonomikë të vendit/rajonit është një hap i parë thelbësor. Çdo ndikues së pari duhet të njihet me kontekstin social dhe ekonomik, i cili ushtron efekt si mbi temat, ashtu edhe mbi rezultatet e ndikimit. Të dhënat socio-ekonomike zakonisht janë një paraqitje fillestare e besueshme e mjedisit politik, të cilat plotësojnë informacionet e mbledhura nga kërkimet, takimet dhe përvoja. Të qenurit i vetëdijshëm për veçoritë e vendit qysh në fillim të procesit mund të të ofrojë një epërsi të madhe ose të të paralajmërojë për pengesat e mundshme para se të investohen burime të konsiderueshme.

Për shembull, duke lexuar të dhënat socio-ekonomike për Shqipërinë, shohim se biznesi i vogël është pjesë e madhe e ekonomisë shqiptare, 92% e të gjitha ndërmarrjeve. Çdo ndikim që synon të ndryshojë legjislacionin për biznesin apo tregtinë përmes lobimit, duhet ta shohë këtë grup si një forcë të madhe lobuese dhe mundësisht të kërkojë këshillat e saj gjatë fazës planifikuese. Po kështu, çdo nismë që ka të bëjë me legjislacionin për tregtinë duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë interesave të bizneseve që tregtojnë me Greqinë dhe Italinë, sepse këto janë dy destinacionet kryesore për eksportet.

Aktorë ndihmës në politikëbërjen shqiptare

Institucionet zyrtare politikëbërëse si Parlamenti apo KM-ja janë vetëm një pjesë e aktorëve të përfshirë në politikëbërje. Edhe në ato vende me procedura të ngurta politikëbërëse ose me deficit demokratik, ka grupe që janë në gjendje të ndërmarrin nisma dhe të ndikojnë politikën publike. Ndikuesit duhet ta mbajnë parasysh këtë kur planifikojnë strategjinë e tyre, sidomos kur zgjedhin audiencën shënjestër dhe kur formojnë partneritete. Në Shqipëri, partitë politike luajnë rolin kryesor në këtë drejtim, por edhe mediat dhe shoqëria civile kanë marrë rëndësi në rritje.

Partitë politike:

Partitë politike janë institucione të përhapura në shoqërinë shqiptare. Numri i partive politike të regjistruara në Shqipëri është mbi tridhjetë megjithëse vetëm gjashtë prej tyre mbajnë vende në parlament. Pushteti politik në Shqipëri është përqendruar në duart e dy partive: Partisë Demokratike (PD) të qendrës së djathtë dhe Partisë Socialiste (PS) të qendrës së majtë. Vitet e fundit ka pasur edhe parti të treta me sasi të konsiderueshme pushteti, si Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), por ato e kanë ushtruar pushtetin vetëm në koalicion me një nga dy partitë e mëdha (si koalicioni i tanishëm me PD-në). E krijuar më 1990-ën, PD-ja është partia e parë opozitare e epokës pas-komuniste. PS-ja u krijua në vitin 1991 nga reformimi i partisë sunduese gjatë komunizmit, Partisë së Punës. Këto dy parti politike mbajnë

shumë nga pushteti politik dhe përcaktojnë më së shumti axhendën e debateve. Pas njëzet viteve shteti demokratik, partitë ende kanë ideologji politike dykuptimëshe që shumicën e herëve përputhen me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, cilësohen si parti të qendrës.

Pavarësisht ngjashmërive, mund të shquajmë edhe dallime të rëndësishme mes historive të dy partive që kanë ndërlikime serioze për përcaktimin e bazës së mbështetësve. Si partia e parë e re pas 45 vjetësh regjimi komunist, PD-ja shërbeu si zëri i opozitës kundër këtij regjimi. Për këtë arsye, partia tërhoqi një numër të konsiderueshëm qytetarësh që ishin shtypur apo keqtrajtuar nga regjimi komunist. Shumica e mbështetësve të saj vinte nga rajonet veriore të Shqipërisë, të cilat shpesh ishin lënë pas dore nga regjimi komunist. Nga ana tjetër, PS-ja, si reformim i Partisë së Punës, fillimisht u bë partia e grupeve që kishin më tepër interes nga statusi kuojë. Kjo rezultoi në një zhvillim interesant lidhur me ideologjitë e partive. Pas rënies së regjimit, grupet që kishin qenë më mirë dhe më të lidhur me statusin kuonë e parë ishin më të përgatitura për të konkurruar në tregun e sapokrijuar dhe patën më tepër sukses në ngritjen e nismave të para private. Kështu, për ironi, PS-ja, në vetvete parti e majtë, u bë më tepër e lidhur me interesat e biznesit. Nga ana tjetër, PD-ja e djathtë u shoqërizua me masat e gjera e të varfra. Sot lidhjet me biznesin janë të forta për të dyja partitë por, duke pasur parasysh rolin e tyre mbizotërues në politikën shqiptare, për ndikuesin fillestar mund të jetë e dobishme të fitojë disa njohuri për historinë dhe rrjetet mbështetëse për secilën parti politike.

Është me rëndësi të theksojmë se partitë politike janë ende në proces konsolidimi të identitetit të tyre në përpjekje për të tërhequr anëtarë të rinj dhe për t'u pëlqyer vendeve perëndimore. Megjithatë, shumica e debateve, sidomos në nivelin ideologjik, pasqyrojnë debatet e ngjashme në perëndim pro partitë shpesh kanë vështirësi në përshtatjen e programit të tyre në kontekstin lokal. Një shembull i debatit aktual është ai për politikën fiskale. Ndërkohë që PS-ja mbron taksën progresive për të lehtësuar bizneset në kohë vështirësish ekonomike, PD-ja i njollos këto politika të së majtës si "marksiste" dhe mbron taksën e sheshtë si mënyrën e vetme për të mos rënë në krizë. Ky debat pasqyrojnë debate të ngjashme në SHBA dhe vende të tjera perëndimore. Kështu, ndikuesit mund të familjarizohen së pari me diskutimet ideologjike në Perëndim për t'u paraprirë debateve të ngjashme këtu në Shqipëri.

Ndërlikimet për ndikimin

Tiparet e sipërpërmendura të partive kryesore politike në Shqipëri janë vetëm një pjesë e debatit të përgjithshëm publik. Si pjesë thelbësore e kulturës politike, ky debat ndikon së tepërmi mënyrën me të cilën dhe zbatohen hartohen politikat e ndryshme. Çka është më e rëndësishme, Shqipëria duke qenë republikë parlamentare, partitë politike në shumicën e rasteve janë të pranishme qysh kur zë fill një politikë e caktuar, para se ajo të debatohet në parlament. Veprimtarët shqiptarë e dinë prej kohësh këtë dhe është praktikë e përhapur mes ndikuesve që t'i trajtojnë çështjet me një nga partitë në pushtet. Veprimtaritë lotuese po ashtu drejtohen shpesh për nga anëtarët e partisë.

Kjo hap një debat të gjerë lidhur me mënyrat e ndryshme me të cilat mund të ndikohet mbi një parti politike. Shumë ndikues në Shqipëri kanë mësuar se një grup i caktuar duhet të bashkohet apo mbështet hapur një parti politike para se të ngrejë një çështje. Po kështu, grupet e interesit shpesh i kanë mbështetur fuqishëm partitë politike gjatë fushatës zgjedhore, qoftë financiarisht, qoftë duke marrë pjesë në proceset e fushatës. Cilado qoftë metoda, sigurimi i mbështetjes së një partie politike apo disa prej anëtarëve të saj për një legjislacion apo kauzë është një nga mënyrat më të sigurta për ta çuar çështjen për diskutim parlamentar apo për të garantuar ekspozimin në media.

Medit kryesore:

Mediat kryesore luajnë rol të rëndësishëm në paraqitjen dhe interpretimin e shumicës së politikave publike. Ajo çka është më e rëndësishme për ndikuesin fillestar, mediat kryesore po ashtu ndikojnë së tepërmi mbi axhendat politike, duke ndikuar në atë se cilave politika do t'u jepet përparësi në kohë të caktuara. Sipas teorisë së përcaktimit të axhendave, mediat mund të ndikojnë në "spikatjen" e temave në axhendën publike (për shembull, McCombs dhe Shaw 1972; Iyengar dhe Kinder 1987; Iyengar 1990). Për shembull, një çështje e transmetuar apo mbuluar shpesh dhe me këmbëngulje nga shtypi ka shumë të ngjarë të perceptohet nga publiku si e një rëndësie më të madhe. Kuptohet që ndikimet e kësaj në axhendat politike janë të shumta. Ekziston edhe një degë studimesh që po merr përherë e më shumë rëndësi: Analiza kritike e mediave, e cila synon të zbërthejë paraqitjet e ndryshme të çështjeve në media dhe të vlerësojë ndikimin e tyre mbi opinionin publik, politikën publike dhe/ose legjitimizimin e politikës.

Shumica e mediave kryesore në Shqipëri është pozicionuar pa drojë me njërin nga forcat kryesore politike. Kjo ka arsye të ndryshme politike dhe ekonomike. Falë forcës depërtuese që ka politika shqiptare në formësimin e diskutimeve publike por edhe mbi mundësitë ekonomike, shumë aktorë e shohin më të lehtë të bëhen aleatë ose me qeverinë ose me opozitën. Shumica e debateve shfaqet brenda strukturash të caktuara që ofrohen nga dy partitë dhe përpjekjet

për analiza të paanshme (ndonjëherë edhe vetë përpjekjet për analiza) shpesh mungojnë. Kjo sigurisht që është e vërtetë për shumë vende të tjera, pavarësisht sistemit politik, sepse mediat kryesore sa vijjnë e bëhen më të varura nga financimet, do me thënë edhe subjektive ndaj grupeve që i financojnë ose subjektive ndaj grupeve që i pengojnë. Në fakt, varësia e mediave nga politika dhe kostot e larta që duhen përballuar nga ndikuesit kur bashkëpunojnë me mediat janë dy disfavore të rëndësishme të mediave si ndërmjetëse të ndikimit. Në këtë drejtim, Interneti po merr përherë e më shumë rëndësi në përkrahjen e alternativave përballë status kuosë së sotme sociale, politike dhe ekonomike.

Ndërlikimet për ndikimin

Pavarësisht paragjytimeve të mëdha, mediat kryesore mbeten mjete të fuqishme në dorë të ndikuesve. Fuqia e tyre për të formësuar opinionin publik mund të përdoret për të mbështetur një kauzë apo për t'i detyruar politikanët të tërhiqen. Për çështje që sfidojnë fort status kuonë, mbështetja fillestare për një çështje mund të sigurohet edhe nëpërmjet *fushatës në Internet*.

Ndikuesi fillestar mund të kuptojë se mediat e dëshirojnë dhe kërkojnë vëmendjen, prandaj media do ta publikojë në një mënyrë apo në një tjetër atë çështje që tërheq vëmendjen e publikut. Për paraqitje sa më të mirë, një analizë mediatike e parë mund të ndihmojë në identifikimin e kanalit që është më i përshtatshëm për të ngritur një çështje të dhënë.

OJQ-të, "think tank"-et dhe OSHC të tjera:

Zhvillimi modelit perëndimor të shtetit liberal e demokratik ka qenë një detyrë e vështirë për shumë vende ish-komuniste. Për të ndihmuar në përshtatjen e këtij sistemi qeverisjeje dhe zhvillimin e një shoqërie civile politikisht aktive, vendet perëndimore kanë financuar me shumicë veprimtaritë e organizatave të shoqërisë civile (OSHC). Gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, OJQ-të, "think tank"-et dhe OSHC të tjera janë shtuar në Shqipëri me projekte të panumërta për ndihmë ndaj nismave demokratike.

Ka kritika të gjera se OJQ-ve shqiptare u mungon baza e qartë ideologjike apo se kanë dështuar në arritjen e ndonjë ndikimi real në terren me projektet e financuara nga donatorët. Megjithatë, këto projekte fillimisht u morën me shumicën e simptomave të varfërisë mjaft të përhapur në vend si dhe ndihmuar në vendosjen e themeleve për të drejtat e pakicave dhe barazisë gjinore. Puna e OSHC-ve është veçanërisht e vështirë në vendet ish-komuniste ku një opinion publik mjaft i mefshtë do të thotë që grupet e ndikimit duhet të përballen me betejat edhe më të vështira.

Një dukuri mjaft e përhapur në nismat e shoqërisë civile në Shqipëri është se shumica e OSHC-ve operon e shkëputur nga sektori publik dhe më së shumti e bashkërendon punën me donatorët e huaj. Në masë të madhe kjo ka të bëjë me faktin se donatorët ndërkombëtarë nuk e kanë kushtëzuar ndihmën me bashkëpunimin me qeverinë, por edhe për shkak të mjedisit tepër të politizuar dhe mungesës së qëndrueshmërisë në administratën publike, çka e bën bashkëpunimin shumë të vështirë. Deri më sot, shumë donatorë ndërkombëtarë zgjedhin partnerë lokalë që bashkëpunojnë gjerësisht me biznesin, botën akademike apo shoqërinë por jo domosdoshmërisht me qeverinë. Kjo e fundit ndoshta ndodh edhe ngaqë qeveria mund të ushtrojë trysni të fortë mbi OSHC-të dhe t'i devijojë përfundimet e projekteve të tyre që të përputhen plotësisht me axhendën e saj. Ky rasti i fundit është monedhë me dy faqe: mund të jetë pozitive sepse siguron integritimin e donatorëve dhe mbështetjen e OSHC-ve ndaj përpjekjeve dhe politikave të qeverisë; por mund të jetë edhe kundërproduktive sepse politika e qeverisë mund të mos mbështetet nga donatorët dhe OSHC-të. Përfundimi është një numër projektsh të pambështetura që varen nga ndihma e huaj e vazhdueshme. Megjithatë, qeveria e Shqipërisë ende luan një rol kyç në bashkërendimin e nismave sociale dhe ekonomike dhe përfshirjen e rezultateve pozitive në kuadrin e saj zyrtar. Prandaj bashkëpunimi i ndikimit pozitiv mes donatorëve dhe OSHC-ve me apo drejt sektorit publik është me përfitime të mëdha për qëndrueshmërinë e reformave politike.

Ka edhe një arsye tjetër pse bashkëpunimi me qeverinë do ta përmirësonte rolin e OSHC-ve në reformat në Shqipëri. Për shkak të një profili tipik asistues të ndihmës ndërkombëtare dhe vështirësive në bashkëpunim me administratën publike, OSHC-të që punojnë në Shqipëri janë përqendruar më së shumti në përkrahjen e kushteve më të mira të jetesës dhe përmirësimin e gjendjes sociale për grupet e ndryshme të marginalizuara. Ka pasur pak punë thelbësore nga ana e shoqërisë civile në trajtimin e pabarazisë në pushtet, deficitin demokratik, të drejtave ekonomike, forcimit të qeverisjes apo reformave të plota ligjore. Këto lloje ndikimesh që merren me pabarazitë ekonomike dhe politike, do me thënë me kuadrin zyrtar të jetës publike, kërkojnë ristrukturim domethënës dhe një bashkëpunim të ngushtë e të vazhdueshëm me sektorin publik.

Ndërlikimet për ndikimin

Vendet ish-komuniste kanë edhe një sektor të tretë mjaft të dobët i cili dobësohet edhe më tepër nga rritja e varësisë prej ndihmës së huaj. Pasi kanë siguruar fondet, OSHC-të shqiptare kanë fare pak nxitje të ndikojnë për ndryshime rrënjësore dhe më tepër zbatojnë modele të gatshme projektsh me ndikim të dobët afatgjatë. Meqë financimet nga donatorët ndërkombëtarë natyrisht po vijnë duke rënë, OSHC-ve do t'u duhet të kërkojnë ndryshime duke ndikuar mbi kuadrin ligjor dhe ekonomik të vendit.

I fuqishëm apo jo, sektori i tretë mbetet thelbësor për ndikuesit. Shoqëria civile ofron për njerëzit mekanizmin që të kryejnë ndryshime duke ndikuar në mënyrë kolektive për këto ndryshime. Kështu, ndikuesit duhet të familjarizohen me të gjitha nismat e tjera në fushën e tyre të interesit, të identifikojnë hapësirat për bashkëpunim dhe mundësisht të nisin të ngrenë partneritete me OSHC-të. Në këtë kuptim, parimet e përbashkëta etike dhe qëllimet e njëjta mund të sjellin një mesazh më efikas për t'u shpërndarë.

Meqë ndihma e huaj për shumë projekte të gatshme po pakësohet, OSHC-të shqiptare duhet të përgatitin veten për rregulloret e BE-së mbi financimet. Ka shumë të ngjarë që projektet më domethënëse dhe të përshtatshme të jenë ata që përfshijnë qeverinë si aktor kyç. Ka ardhur koha që OSHC-të të nisin të ndërtojnë ura me strukturat qeveritare, pavarësisht shumë vështirësive. Kjo jo vetëm që do t'i lejojë të përdorin këto ura për të ndikuar mbi politikëbërjen legjislative dhe ekzekutive, por do të rezultojë edhe në projekte më domethënëse dhe të qëndrueshme.

IV. Ndikimi përmes ciklit politik

Kreu i mëparshëm merrej me kontekstin legjislativ, institucional e civil të politikëbërjes publike si dhe me ndërlikimet e tyre për ushtrimin e ndikimit. Qëllimi ishte të theksohej rëndësia e njohjes së tërësishme të sistemit politik. Ushtruesit e ndikimit mund t'i identifikojnë lehtë mundësitë për ndërhyrje nëse i gjithë procesi është i qartë. Pas njohjes me natyrën e përgjithshme të politikave publike dhe veçantitë e kontekstit shqiptar, po kalojmë në procesin aktual politikëbërës dhe mënyrat me të cilat mund të ushtrohet ndikim mbi të.

Ka shumë struktura analitike dhe konceptuale për të kuptuar politikën publike. Asnjëra prej tyre nuk është gjithëpërfshirëse dhe praktikuesit e ndikimit mund të zgjedhin cilindo model që u duket më i përshtatshëm apo të kombinojnë qasje të ndryshme për të ndikuar mbi procesin (në fakt, ka edhe nga ata që nuk e identifikojnë fare politikëbërjen si proces). Në këtë mënyrë, meqë ky udhërrëfyes u drejtohet fillestarëve, nuk do të futemi në gjithë strukturat e ndryshme teorike që synojnë të shpjegojnë mënyrat e hartimit, miratimit dhe zbatimit të politikave. Më tepër, kemi përzgjedhur një model konceptual të përdorshëm gjerësisht, atë të ciklit politik, për ta paraqitur politikëbërjen si një proces hap pas hapi, duke identifikuar pikat hyrëse për ndikuesit që synojnë të ushtrojnë ndikim mbi të. Ky është një model konceptual mjaft i njohur dhe shumë analistë politikë e përdorin ciklin politik si një lloj strukture për të kuptuar procesin se si zhvillohen politikat.

o Modeli hap pas hapi dhe cikli politik

Cikli politik përshkruan se si lëviz një çështje drejt vënies në zbatim dhe së fundi drejt vlerësimit përmes fazave të njëpasnjëshme dhe të rezultateve që prodhon. Kemi zgjedhur ciklin me pesë faza sepse ai është një model mjaft i përhapur dhe veçanërisht i përshtatshëm për ndikuesit. Ka edhe paraqitje të tjera që përcaktojnë vetëm tri faza (zhvillimi i politikës, zbatimi dhe vlerësimi) ose që e ndajnë procesin në tetë faza (nga identifikimi i çështjes te vlerësimi)¹⁶. Disa nuk e përmendin fare hartimin e axhendës për përqendrohen te identifikimi i problemit. Sido që të jetë, cikli politik mund të përshtatet për politikën publike në fjalë dhe është më tepër një mjet elastik për të drejtuar procesin politik sesa një model i ngurtë. Ajo që ka rëndësi për ndikuesin fillestar është të bëjë dallimin mes fazave të ndryshme kryesore në ciklin politik dhe të jetë në gjendje të dallojë qasjet e ndryshme konceptuale të përdorura në faza të ndryshme. Për shembull, një qasje ndikuese për të ndërhyrë në fazën planifikuese ndryshon shumë nga qasja ndikuese e cila kryhet në fazën e marrjes së vendimit.

16. Shih për shembull Bridgman dhe Davis 1998.

Ne kemi zgjedhur ciklin politik me pesë faza të paraqitur nga Howlett dhe Ramesh (1995). Figura 5 tregon një paraqitje grafike të ciklit politik. Figura 6 paraqet secilën fazë dhe, përkatësisht, rezultatet e lidhura me të. Çdo fazë e ciklit politik përkon me një fazë kontekstuale të zgjidhjes së aplikuar të problemit prandaj dhe ky model është tepër i dobishëm në trajtimin e një nevojë specifike apo problemi.

Figura 5: Cikli politik sipas strukturës me pesë faza (burimi: përpunim i yni)





Figura 6: Pesë fazat e ciklit politik (burimi: Howlett dhe Ramesh, 1995)



o Përcaktimi i axhendës: si ta bësh të dukshme një çështje

E përmendëm rëndësinë e hartimit të axhendës kur përshkruam rolin e mediave kryesore në politikëbërje. Gjatë kësaj faze, politikëbërësit publikë e njohin morinë e problemeve që duhen trajtuar për një periudhë të caktuar (për shembull, gjatë një mandati elektoral). Kjo fazë është veçanërisht e rëndësishme për ndikuesit. Është gjithmonë më e vështirë ndërfitja e një çështjeje kur axhenda është përcaktuar një herë. Për shembull, nëse buxheti i një ministrie për vitin në vazhdim pak a shumë është vendosur, është shumë e vështirë të propozohen nisma të paparashikuara që mund të kërkojnë financime shtesë.

Shkencëtarët politikë dallojnë dy lloje bazë axhendash: sistemike dhe institucionale. Axhendat sistemike paraqesin politikat e përgjithshme të qeverive. Për shembull, aktualisht në Shqipëri, integrimi në BE është pjesë integrale e axhendës sistemike. Axhenda sistemike mund të hartohet me çështje për të cilat ekziston ndërgjegjësim i lartë publik.

Axhenda institucionale zakonisht lidhet me planin e punës dhe objektivat për institucionet e veçanta. Këto zakonisht nuk diskutohen gjerësisht në publik dhe përfshijnë bisedime për buxhetin e shtetit, takimet zyrtare apo propozimet për legjislacionin e ri në fusha të caktuara.

Qëllimi i parë i ndikuesve mbi politikën është ta fusin çështjen në axhendën e individëve, grupeve apo institucioneve që kanë pushtet për të kryer ndryshime. Kjo është detyrë e ngatërruar sepse ndikuesit duhet të konkurrojnë me grupe të tjera që të tërheqin vëmendjen e politikanëve. Në Shqipëri, numri i lartë i problemeve socio-ekonomike do të thotë që ka grupe të shumta të cilat përpiqen të fusin çështjet e tyre në fushën e vëmendjes së politikanëve ose publikut, shpesh duke përdorur edhe qasje agresive ndikimi. Në këtë mënyrë, përcaktimi i axhendës është një proces konkurrimi për vëmendje, kohë dhe burime mes ligjvënësve, të interesuarve dhe publikut të gjerë.

Axhendat politike mund të duken si të ngurta nga përmbajtja, pa hapësirë për elasticitet dhe pika të reja. Gjithmonë gjendet një grup politikash që konsiderohet si përparësi. Dhe strategjitë e mëdha përcaktojnë shpesh se cila propozime të reja politike do të mirëprehen nga qeveria dhe cilat nuk janë në linjë me objektivat strategjike. Për shembull, në qeverisjet e fundit, çdo çështje që mund të shkonte kundër kërkesave të integritimit evropian, ka shumë të ngjarë të hidhej poshtë. Megjithatë ka hapësirë për ndërhyrje nëse ndikuesi është familjar me diskutimet e ditës dhe aktorët që përcaktojnë axhendën kryesore. Për të ditur se cilat politika po diskutohen në një kohë të dhënë dhe për të gjetur hapësira për ndërhyrje ose nisma të përbashkëta, një vëmendje e madhe u duhet kushtuar fjalimeve të kryeministrit, udhëheqësve të partive, premtimeve zgjedhore dhe diskutimeve të përgjithshme politike në media.

Nuk ka rrugë të prerë me thikë për t'u siguruar që një çështje të futet në axhendën e ligjvënësve ndërkohë që në kontekste të ndryshme përdoren mekanizma të ndryshme. Megjithatë, njohuritë mbi literaturën e teorive për hartimin e axhendave mund të jenë një hap i parë i dobishëm. Ka literaturë të bollshme për përcaktimin e axhendave në demokracitë perëndimore, sidomos në SHBA. Për shembull, Kingdon (1995) flet për nocionin e dritares politike, e cila është pjesë e rëndësishme e teorisë mbi hartimin e axhendave. Dritarja politike është atëherë kur del një mundësi për të ndryshuar drejtimin e politikës. Dritaret politike mund të krijohen duke shkaktuar ose drejtuar vëmendjen te ngjarje të caktuara, si aksidente apo katastrofa, si dhe nga ndryshimet në qeveri dhe ndryshime në opinionin publik. Dritarja politike ofron mundësi për çdo grup të aftë të mobilizojë mbështetje për një grup të caktuar politikash¹⁷. Për të krijuar hapësirë për një dritare politike ndikuesit duhet t'i përqendrojnë përpjekjet në tri drejtime kryesore veprimi:

- **Rryma politike:** identifikimi i çështjeve mbi të cilat lojtarët politikë përpiqen të sigurojnë veprim. Në këtë linjë pune, ndikuesit mund të përdorin veprimtaritë lobuese për të bindur zyrtarët publikë për rëndësinë e çështjes duke u paraqitur përfitimet politike, rëndësinë historike dhe meritat e politikës.
- **Rryma e propozimeve:** krijimi i propozimeve për zgjidhjet e problemit që duan të paraqesin. Ligjvënësve nuk u pëlqen të flasin për çështje që nuk kanë zgjidhje, strategji të qarta dhe plan veprimi. Këto mund të transmetohen përmes propozimeve politike ose raporteve analizuese të problemit.

17. Kingdon, 1995.

- **Rryma e problemit:** siguron kuptimin nga publiku të çështjes ose fiton mbështetjen publike. Strategjia e komunikimit dhe ngritja e përkrahjes mund të përdoren për të siguruar ndërgjegjësimin e publikut.

Si shembull të një ndikimi të madh të nisur gjatë fazës përcaktuese të axhendës, duke përdorur një dritare politike të hapur, mund të shohim sesi u ndërftën së pari politikat mjedisore në axhendë e qeverisë së SHBA-së në fund të viteve 1980.

Mjedisorët neoliberalë në SHBA më në fund ia dolën të fusnin çështjen e tyre në axhendën e qeverisë kur u krijua një dritare politike në fund të viteve 1980. Mundësia ishte rezultat i rritjes së mbulimit të çështjeve mjedisore nga mediat në fund të viteve 1980, e kombinuar me publikimin dhe miratimin nga OKB-ja të Raportit Brundtland. Kjo dritare u përdor për të futur politikat mjedisore në axhendat politike të shumë qeverive¹⁸.

Një shembull nga përvoja e Co-PLAN lidhur me përcaktimin e axhendës është puna e kryer me ndërtimet informate në Shqipëri përpara se të hartohet një politikë publike që të trajtonte këtë çështje. Co-PLAN punoi intensivisht në zonat si Bathorja gjatë viteve 1995-2005 për të nxitur urbanizimin dhe përfshirjen si dhe për një politikë përfshirëse për këtë zonë. Këto nisma ishin mes shtysave të para që do të krijonin kuadrin e parë politik shqiptar në planifikimin dhe zhvillimin urban.

o Formulimi i politikës: strukturimi dhe ngritja e konsensusit

Pasi të jetë përcaktuar axhenda, faza tjetër e ciklit të politikës publike është Formulimi i politikës. Kjo ndodh kur problemi është strukturuar qartë dhe janë zhvilluar propozimet për zgjidhje politike. Kjo fazë përfshin planifikimin dhe programimin si dhe përgatitjen e planeve të veprimit dhe projektligjeve. Dy janë kërkesat kryesore gjatë kësaj faze: (1) Ekspertiza e fushës dhe (2) Ngritja e konsensusit. Që të dyja ndikojnë së tepërmi në rolin e ndikuesve potencialë në këtë fazë të ciklit.

Ekspertiza e fushës:

Faza e formulimit të politikës në radhë të parë (dhe disa thonë që është edhe më e rëndësishmja) ka të bëjë me strukturimin e problemit dhe politikës. Mënyra se si ngrihet dhe shtrohet problemi pa dyshim që ndikon mbi formulimin e politikës. Kjo është një fazë thelbësore për përfshirjen e aktorëve “të jashtëm” në procesin politikëbërës, pavarësisht

18. Beder, 2002.

sa i ngurtë dhe jodemokratik mund të jetë procesi. Arsyeja është se në këtë fazë kërkohet një shkallë e lartë ekspertize për të përshkruar çështjen, për të vlerësuar përfundimet dhe për të peshuar kostot e përfitimet e secilës nga zgjidhjet e diskutuara. Aktorëve zyrtarë në politikëbërje, si politikanët apo ligjvënësit, u duhen ekspertë të fushës për t'u përgatitur gjatë kësaj faze. Kështu, pavarësisht nëse politikanët duan apo nuk duan ta bëjnë përfshirës këtë proces, ka hapësirë për ekspertët që të ndikojnë mjaft mbi procesin që nga fillimi i formulimit dhe gjatë gjithë fazës së formulimit të politikës. Vërtet, grupet që ia dalin të bëhen pjesë e procesit rrallë janë të pavarura dhe ka shumë mundësi që të zbatohen disa kriteret për përzgjedhjen e ekspertizës. Për shembull, politikanët ka shumë të ngjarë të përzgjedhin ekspertë të fushës që janë të të njëjtave bindje politike apo që mbështesin ideologjinë e partisë së tyre. Megjithatë, faza e formulimit të politikës ndoshta është faza që ofron më tepër hapësira për përfshirjen e grupeve të ndryshme të fushës, bashkësive epistemike apo grupeve të ekspertizës në kanalet zyrtare të politikëbërjes. Këtu ndodh rrahja e mendimeve dhe prandaj ka mundësi të jetë faza më e rëndësishme për disa lloje ndikimesh, ku mund të kërkohet trajtimi i anës mendore të strukturës së problemit.

Le të marrim një shembull nga përgatitja e Reformës së arsimit të lartë në Shqipëri, i cili futi Procesin e Bolonjës në universitetet shqiptare. Kjo njihet si një nga reformat me pjesëmarrjen më të lartë të stafit akademik në fazën e formulimit, pikërisht sepse përfshinte një sektor ku politikanët ishin të paafte të ndërtonin një politikë pa ndihmën e ekspertëve të fushës. Megjithëse reforma sigurisht iu nënshtrua “imperativit të integritetit”, me qeverinë që anashkaloj shumë ankesa nga grupet e punës të ekspertëve në emër të evropianizimit të arsimit të lartë në Shqipëri, ekspertët përsëri ushtruan një ndikim të fuqishëm në këtë reformë.

Ngritja e konsensusit:

Meqë faza formuluese paraprin fazën vendimmarrëse, ngritja e konsensusit merr një rëndësi mjaft të madhe. Konsensusi mes politikanëve dhe publikut lehtëson si votimin ashtu edhe zbatimin e politikës. Por ai legjitimon edhe vetë politikën, çka mbetet një aspekt thelbësor i grupeve politike që synojnë rizgjedhjen. Kështu, negociatat e gjera që zhvillohen mbulojnë një varg të gjatë temash lidhur me politikën në fjalë. Disa nga negociatat më të ashpra zakonisht ndodhin mes pjesëmarrësve të ndryshëm, sidomos kur kanë interesa të kundërta. Ngritja e konsensusit mund të jetë vërtet sfidë në këtë fazë për shkak të njohurive dhe sfontëve të ndryshme të grupeve të përfshira. Dallimet politike dhe ideologjike po ashtu e bëjnë këtë proces mjaft delikat.

Ndërkohë që qeveritë mund ta përballojnë një pjesëmarrje të cekët në proces (dhe më pas të miratojnë një politikë të caktuar, pavarësisht përfundimit të diskutimeve) ndikuesit duhet ta marrin tepër seriozisht fazën formuluese dhe

debatet që shoqërojnë atë. Në ciklin politik, kjo është faza më e hapur e rrahjes së mendimeve dhe mundësitë për të ndikuar procesin janë më të mëdha në këtë pikë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për nismat ndikuese që e kanë origjinën nga lëvizjet e shoqërisë civile ose nga kanalet jozyrtare. Kjo është mundësia e tyre më e mirë për të hyrë në një procedurë zyrtare e të ngurtë.

Gjatë procesit të arritjes së konsensusit, ndikuesit fillestarë duhet të jetë të kujdesshëm të mos legjitimojnë çdo lloj politike mbi të cilën po përpunohen të ndikojnë. Pjesëmarrje nuk do të thotë domosdoshmërisht që zëri juaj po dëgjohet apo po merret për bazë, ndërkohë që pjesëmarrja e gjerë mund të përdoret nga forcat politike për të përligjur dhe legjitimuar një politikë pa e përdorur fare procesin e rrahjes së mendimeve. Kjo ndodh shpesh me reformat politike që kanë një bazë të paracaktuar ideologjike ose strategjike.

Siç e përmendëm më sipër, rrahja e mendimeve që ndodhi para miratimit të reformës së arsimit të lartë në Shqipëri, nuk u përdor për të konceptuar vetë reformën. Procesi i Bolonjës tashmë ishte përzgjedhur nga qeveria shqiptare si rruga për arsimin e lartë shqiptar. Më tepër, zëri i akademikëve dhe ekspertëve të tjerë shkoi për të strukturuar elementë të ndryshëm strukturorë të reformës dhe për përshtatjen e saj në kontekstin shqiptar.

Një shembull tjetër nga përvoja e Co-PLAN lidhur me formulimin e politikës është ai i Politikës për Zhvillimin e Territorit që u projektua nga Co-PLAN në vitin 2005 dhe u paraqit partive politike para zgjedhjeve.

o **Vendimmarrja: ndikimi përmes levave**

Kjo është faza e tretë e ciklit politik. Parlamenti dhe/ose KM-ja miraton ligjet dhe rregulloret, objektivat politike përcaktohen qartë dhe zhvillohen mjetet për të arritur këto objektiva. Vendimi zyrtar për një opsion politik të parapëlqyer merret mbështetur në përparësitë e përgjithshme të qeverisë por edhe mbështetur mbi paraqitjen e propozimeve alternative në fazën paraprëse, mbi kostot dhe përfitimet si dhe mbi fizibilitetin e tyre.

Në Shqipëri, politikat kryesore miratohen nga parlamenti ndërsa vendimet që kanë të bëjnë me politika më të vogla apo me mendime i lihen KM-së, që i miraton përmes vendimit ekzekutiv. Ka ndryshore të shumta që ndikojnë në procesin vendimmarrës, nga ato etike në financiare. Për ndikuesin fillestar e rëndësishme është ta njohë procesin vendimmarrës dhe të jetë në gjendje t'u afrohet në mënyrë të përshtatshme dhe në kohë vendimmarrësve.

Përmasa "individuale" e politikëbërjes bëhet tepër e rëndësishme në këtë fazë prandja nuk është më e përshtatshme të paraqesësh dokumente të gjata kërkimore apo propozime politike. Ndikuesi nuk përballë më me komisione

vlerësuese apo grupe ekspertësh. Më shumë tani e ka në dorë politikani në parlament apo ekzekutivi. Kjo nuk do të thotë se nuk ka vend për ndërhyrje në fazën vendimmarrëse. Secila nga fazat e ciklit politik ofron mundësi ndikimi, por vetëm nëse ky vjen me argumentet e duhura dhe, çka është më e rëndësishme, me levat e duhura.

Kjo mund të jetë koha e përshtatshme për të përdorur rrjetet që ke ngritur dhe për të shfaqur mbështetjen e publikut që ke siguruar për alternativën tënde. Shumë politikanë nuk i miratojnë politikat kundërtëne, veç rastit kur këto mbështeten nga një numër i lartë qytetarësh. Në këtë mënyrë ata sigurojnë rizgjedhjen prandaj edhe çdo alternativë e parashtruar të vendimmarrësit duhet shprehur në formën e një kapitali politik. Ofrimi i mbështetjes gjatë zgjedhjeve në shkëmbim të një politike të caktuar është metodë e përhapur ndikimi në këtë fazë.

Sidoqoftë, ndikuesi duhet ta ketë shumë të qartë se cilët janë vendimmarrësit kryesorë. Sidomos në sistemet parlamentare, partitë votojnë pak a shumë njëzëri për çështje të caktuara. Mund të ndodhë që disa individë të jenë përgjegjës lidhur me atë se si voton i gjithë grupi në parlament. Ndikuesi duhet t'i përcaktojë se kush janë këta individë dhe pastaj të përpunojë metodën e duhur të qasjes ndaj tyre.

Në Shqipëri, një shembull i ndikimit të fortë publik në vendimmarrjen zyrtare ishte kthimi nga Gjykata Kushtetuese i marrëveshjes detare për ujërat me Greqinë. Kërkesës për rishikim kushtetues iu mëshua nga opozita e mbështetur nga ekspertë të ndryshëm nga fusha e historisë dhe ligjit ndërkombëtar si dhe nga përfaqësues të shoqërisë civile.

o **Zbatimi i politikës: ndikimi mbi pasojat dhe kontrolli i dëmit**

Procesi i zbatimit të politikës ka të bëjë me vënien në zbatim të vendimeve. Megjithëse mund të duket sikur në këtë fazë ndodhin më pak diskutime, proceset zbatuese nuk janë dhe aq të lehta sa mund të mendohet. Zbatimi me sukses shpesh shkon përtej përpikmërisë me të cilën janë hartuar planet e veprimit më parë. Prandaj në fazat planifikuese të një politike përpunohen skenarë të ndryshëm për të rritur kontrollin mbi ndryshore potencialisht të paparashikueshme.

Zbatimi i politikës ka të bëjë me produktin e politikës, por edhe me mënyrën se si do të ndikojë ky produkt mbi të interesuarit. Kështu, ka dy përmasa të zbatimit, çdonjëra nga të cilat mbart sfida të mëdha për procesin. Së pari, zbatimi i politikës sjell detyrimin për ndryshimin e zakoneve dhe ngulitjen e mënyrave të reja për të bërë gjërat. Dështimi i arritjes së këtij ndryshimi është një nga shkaqet më të përhapura për dështimin e politikës ose, siç thuhet shpesh, politika mbetet "në letër" me fare pak ndikim në terren. Shembuj janë përpjekjet për të rregulluar menaxhimin e mbeturinave

në Shqipëri gjatë viteve të fundit, të cilat treguan se sa rezistentë ndaj ndryshimit janë disa praktika ekzistuese. Së dyti, zbatimi i politikës mund të prekë në mënyra të ndryshme grupe të ndryshme. Për shembull, ndërtimi i një dige lumi që rrit prodhimin e energjisë elektrike sjell përfitime për popullsinë e mbarë një vendi. Megjithatë, nëse janë planifikuar zhvendosje popullsie për të krijuar hapësirën e nevojshme për digën, grupe të veçanta do të dëmtohen rëndë nga ky projekt. Në këtë mënyrë, zbatimi i politikës shpesh është një betejë për të arritur rezultatet më të mira të mundshme me sa më pak dëme. Për këtë arsye, zbatimi i politikës nuk ka të bëjë vetëm me rezultatet e saj, por edhe me ndikimet më të rëndësishme.

Ekzistojnë opinione të ndryshme lidhur me arsyet pse disa politika kanë sukses e të tjera dështojnë, ndërsa debatet mbi atë që ka shkuar keq mund të vazhdojnë gjatë edhe pasi një politikë të ketë marrë fund. Në fakt, shpesh ka një farë pasigurie mes vendimmarrësve nëse një politikë e dhënë do t'ia arrijë qëllimit, deri në çastin kur nis faza e zbatimit. Shpesh ndodh që një politikë që duket krejt e përsosur në letër, të përballet me probleme të pakapërcyeshme në zbatim.

Në Shqipëri, një nga ligjet më problematike që vuajti nga rrjedhoja të papritura ishte faza zbatuese e ligjit Nr. 9481, data 3.4.2006 për "Legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" me përmirësimet e veta. Për shkak të vështirësive të paparashikuara në zbatim, ky ligj u amendua tri herë nga parlamenti (në 2007, 2008 dhe 2009), ndërkohë që disa nene të tij u shpallën jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2009. Këto mendime ndikuan së tepërmi në efikasitetin dhe legjitimitetin e këtij ligji.

Pavarësisht natyrës së brishtë të procesit zbatues, ka mjaft hapësira në këtë fazë për të ndikuar në zbatimin e tij. Shumë ushtrime ndikimi në fakt vënë në shënjestër fazat zbatuese të politikave të ndryshme duke u përpjekur të sigurojnë një proces të drejtë e të paanshëm për atë që besojnë se është politika e duhur. Këto ndikime bëhen pjesë aktive e zbatimit për të penguar parregullsitë apo shmangiet.

Le t'i kthehemi edhe një herë shembullit tonë me projektin e ndërtimit të digës: Nëse projekti është miratuar dhe do të ndodhin vërtet zhvendosje njerëzish, përkrahësit e tyre ndonjëherë do të vazhdojnë të jetë të përfshirë plotësisht në fazat e zbatimit. Synimi i tyre do të jetë të sigurojnë dëmin minimal mbi popullsinë e zonës dhe të negociojnë kushte të favorshme për zhvendosjen. Kështu, nëse zhvendosja është e pashmangshme, ndikuesit tani përpiqen të ulin në minimum ndikimin mbi popullatën.

o Vlerësimi i politikës

Vlerësimi i politikës paraqitet këtu si faza e pestë e ciklit politik. Shumë politika publike i nënshtrohen vlerësimeve të ndryshme, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Këto mund të rezultojnë me përshtatje ndaj këtyre politikave apo me përfundimin e tyre (falë arritjes së qëllimeve ose për shkak të rezultateve tepër negative). Çdo aktor kryen vlerësime me një qëllim të caktuar në mendje dhe shpesh duhen parë disa vlerësime të ndryshme për të përcaktuar nëse një politikë e caktuar ia ka arritur apo jo qëllimit. Vlerësimet shohin edhe efektet anësore dhe rezultatet e paparashikuara të një politike, sidomos kur ajo sjell më tepër dëme se të mira, duke vlerësuar se kush fiton e kush humb për shkak të një politike të caktuar, çfarë rreziqesh paraqet dhe si materializohen ato.

Vlerësimi është një proces i vazhdueshëm, i cili kryhet në vijimësi përgjatë procesit politik dhe, së fundi, para përmbylljes së kësaj politike. Sidomos në projektet afatgjata, vlerësimet përdoren për fazat pasardhëse dhe për ta përshtatur politikën nëse kjo është e nevojshme. Kështu, vlerësimi kryhet edhe përgjatë ciklit, edhe në fazën e fundit të procesit politik.

Vlerësimi si monitorim përgjatë ciklit

Megjithëse është vendosur si faza e fundit e ciklit, vlerësimi i politikës në fakt ndodh në fazat të ndryshme të procesit politik. Kjo mund të vërehet kur shohim një proces të caktuar politik të shkëputur nga arena e gjerë e politikëbërjes. Veç nismave afatshkurtra, që zakonisht janë shprehje e një politike më të gjerë sesa politika në vetvete, të gjitha politikat vlerësohen në shumë pika gjatë procesit. Vlerësimi mund të kryhet edhe para zbatimit, për të parë, për shembull, nëse palët e interesuara janë përfshirë vërtet në të ose mund të ndodhë gjatë zbatimit për të parë nëse janë arritur qëllimet apo nëse nevojiten ndryshime. Në cilëndo fazë, procesi i vlerësimit jep një pamje të gjendjes dhe lejon reflektime e ndryshime.

Kjo është në të njëjtën linjë me natyrën ciklike të procesit politik ku vlerësime të vazhdueshme mund të çojnë në përshtatjen, rivlerësimin apo edhe ristrukturimin e tij. Për shembull, kur një politikë vlerësohet para se të zbatohet, bëhen përpjekje për të parashikuar pasojat e saj gjatë zbatimit. Këto vlerësime periodike njihen me emrin **monitorime**. Monitorimi i politikës kryhet për të mbledhur prova rreth një politike ndërkohë që ajo është në zbatim e sipër dhe pastaj këto gjetje përdoren për të ndikuar mbi rrjedhën e mëtejshme të veprimeve. Ka tre përbërës të punës monitoruese ndaj politikës: *mbledhja e provave, analizimi i provave dhe ndikimi mbi rrjedhën e politikës*.

Figura 7: hapat e monitorimit të politikës (burimi: përpunim i yni)



Ndikuesit janë veçanërisht aktivë në monitorim dhe përballen me shumë sfida gjatë gjithë fazave. Është i nevojshëm një plan i hollësishëm monitorimi, me objektiva të qarta dhe tregues të përpunuar mirë. Kjo mund të kërkojë mjaft kohë dhe burime. Kur mbledh provat, qasja ndaj informacionit politik dhe mbledhja e dokumenteve politike mund të jetë tepër e vështirë (çka njihet ndryshe me fjalët zbrazëti informative). Analizimi i provave kërkon mjaft ekspertizë dhe burime (e ashtuquajtura zbrazëti aftësish). Ndërkohë që ndikimi i rrjedhës së politikës kërkon përcaktime të kujdesshme kohore.

Për të ilustruar vetëm një nga këto sfida në kontekstin shqiptar, mund t'i hedhim një sy mbledhjes së të dhënave, që mund të jetë një proces tepër i vështirë për ndikuesit, kërkuesit dhe praktikuesit e politikës. Zbrazëtia informative bëhet edhe më e madhe në vende me demokraci të reja që vuajnë nga mungesa e transparencës apo, në përgjithësi, nga mungesa e bazave të të dhënave të hapura për publikun. Në Shqipëri, ky rol përmbushet nga INSTAT-i, i cili është kanali i vetëm zyrtar për statistikat qeveritare. Një kanal alternativ që do të ofronte të dhëna krahasuese ende mungon në Shqipëri. Vetëm së fundmi institutet kërkimore kanë filluar ta mbushin këtë zbrazëti.

Për të trajtuar mungesën e të dhënave publike ose seriozitetin e ulët të të dhënave të disponueshme, shumë ndikues në vendet e zhvilluara u kthehen metodave sasiore të kërkimit dhe mbledhjes së të dhënave. Intervista me grupe të fokusuara, për shembull, po përdoren përherë e më shumë për të mbuluar mungesën e statistikave zyrtare apo për të përmbushur nevojën për perspektiva alternative/alternative perspectives.

Siç u tha, është më e lehtë të futës rezultatet në proces nëse politika është ende në fazat planifikuese. Nga ana tjetër, përfshirja e rezultateve të vlerësimit më vonë në proces do të kërkojë një qasje më proaktive, meqë rruga e zbatimit tashmë është përcaktuar. Prandaj ndodh që vlerësimet e skenarëve të ndryshëm zakonisht ndodhin kur planifikohet politika, për t'u paraprirë rezultateve dhe për të mbrojtur një rrjedhë të ndryshme politike para fazës së vendimmarrjes.

Vlerësimi si fazë përfundimtare

Vlerësimi i politikës kryhet kur një projekt apo politikë e caktuar është pranë përfundimit. Zakonisht kjo kërkon të shohë ndikimet e një politike të caktuar. Vlerësimi i politikës, si fazë përmbyllëse e ciklit politik, përfshin aktet e rishikimit administrativ, juridik dhe politik që synojnë të vlerësojnë produktet dhe ndikimet e një politike. Pas vlerësimit përfundimtar, programet politike mund të mbyllen ose të përshtaten për të siguruar të ardhme të qëndrueshme.

Vlerësimet e politikës publike zakonisht vëzhgojnë katër fusha: efektin mbi problemin e vënë në shënjestër, ndikimet afatshkurtra dhe afatgjata si dhe kostot ekonomike. Procesi është tepër i rëndësishëm për ndikuesit, sidomos për ndikuesit fillestarë që duhet të njihen me politikën e shkuara dhe përfundimet e tyre para se të nisin të planifikojnë nismën e tyre.

Agjencitë qeveritare përfshihen shpesh në vlerësime, meqë ky është një hap i kërkuar në çdo proces politik. Por aktorët më të interesuar në këtë fazë janë zakonisht aktorët joqeveritarë që nga mediat, bota akademike e shoqëria civile. OSHC-të, studiuesit, dhe qendrat kërkimore, institutet dhe grupet e interesit publik kryejnë vlerësime të politikave për të parashikuar ndikimet e politikave të ngjashme në të ardhmen dhe për të vlerësuar efikasitetin e tyre. Në fakt, shumë ushtrues ndikimi i nisin veprimtaritë e tyre duke vlerësuar politikën e ngjashme në kohë të ndryshme, në vende të ndryshme apo thjesht në kontekste të ndryshme. Këto vlerësime formojnë bazën për kërkimet politike, si një nga mjetet më të përhapura për të nisur një plan ndikimi.

Një shembull nga konteksti shqiptar do të ishte Raporti Monitorues i Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, i cili synonte të monitoronte përparimin dhe përmbushjet e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit. Kjo nismë u ndërmor nga OSI dhe mbulonte periudhën qershor 2006-shtator 2007.

Përfundimisht, qëllimi është të vlerësohet nëse politika, me kostot e përfitimet e saj, ishte një nismë e dobishme si dhe për të nxjerrë mësim për politikën e ardhshme publike. Vlerësimet nga politikën specifike ndërfiten në planifikimet për politikën e ardhshme. Kështu, procesi i politikës publike është një cikël i vazhdueshëm ku rezultatet e çdo politike përdoren për të përmirësuar politikëbërjen në të ardhmen.

V. Cikli i ndikimit mbi politikën dhe mjetet

Pasi dhamë një pamje të gjerë të mjedisit politik në Shqipëri dhe një sfond të politikave publike dhe të ciklit politik, kreu në vijim jep disa hapa kyçe që mund të ndihmojnë në ndërmarrjen e një fushatë të suksesshme ndikimi mbi politikën si dhe disa mjete në dispozicion të ndikuesit. Këto mund të shërbejnë si bazë për organizimin e përpjekjeve në një nismë të strukturuar ose thjesht për përçimin qartë të mesazhit te audiencia e duhur.


o Cikli i ndikimit si strukturë e nismave ndikuese

Njësoj si çdo nismë tjetër, edhe fushatat e ndikimit kalojnë nëpër një numër fazash duke nisur nga identifikimi i çështjes deri te vlerësimi i gjithë fushatës. Njësoj si me zhvillimin e politikave, ka një numër rrugësh që mund të ndiqen kur organizon një fushatë ndikuese mbi politikën dhe asnjëra prej këtyre rrugëve nuk quhet si më e mira. Mund të vihen në zbatim qasje të ndryshme në varësi të kushteve të jashtme apo burimeve në dispozicion. Ndërhyrjet mund të organizohen qysh më herët (për shembull, puna me grupet parlamentare për t'i dhënë formë një ligji të caktuar) ose mund të përdoren veprime spontane (për shembull protesta në përgjigje të një politike të caktuar). Është e rëndësishme

të mbahet mend se konteksti është gjithçka kur vjen puna te ushtrimi i ndikimit (Carden 2005, 2009) dhe “ndikuesit duhet të jenë tepër të kujdesshëm kur transferojnë qasjet e ndikimit të “praktikave të mira” nga një kontekst në tjetrin” (Young dhe Quinn 2012: 53).


Megjithatë, njësoj si për nismat e tjera, planifikimi i saktë dhe ideja e qartë e fazave nëpër të cilat kalon procesi ndihmon shumë në realizimin me sukses të fushatës. Në fakt, fushatat e ndikimit mbi politikën në vetvete ndryshojnë nga veprimet e improvizuara sepse ato organizohen qysh më herët, përfshijnë një farë planifikimi dhe ndjekin një zhvillim të strukturuar. Duke u nisur nga përvoja e Co-PLAN, gjatë këtij kreu e kemi ofruar ciklin e ndikimit mbi politikën si një strukturë të përbërë nga pesë faza kyçe të cilat mund të shërbejnë si udhërrëfyese për nismën tonë. Qasja duhet të ndihmojë në organizimin e përpjekjeve për një fushatë ndikimi mbi politikën.

Figura 8: Cikli i ndikimit mbi politikën (burimi: përpunim i Co-PLAN)



TCikli i ndikimit mbi politikën nuk duhet interpretuar si proces që duhet filluar vetëm në fazat e para të politikëbërjes. Fushata ndikuese në fakt mund të nisët në cilëndo fazë të ciklit politik, për sa kohë jemi në gjendje të përshtatim qasjen dhe mjetet me atë fazë. Për shembull, lobimi mund të jetë qasje e mirë për të ndikuar në fazën e përcaktimit të axhendave. Ose, nëse synojmë të ndikojmë mbi një politikë qysh në konceptimin e saj, përfshirja politike në strukturat zyrtare ligjëbërëse, si grupet parlamentare, mund të ketë përparësi. Nga ana tjetër, përfshirja në fazën zbatuese mund të kërkojë ekspertizë të lartë teknike. Është e rëndësishme të mbahet parasysh se ka qasje dhe mjete në dispozicion për secilën fazë të ciklit politik dhe se cikli i ndikimit mbi politikën mund të nisët në secilën nga fazat e së parës. Këtë përkthim e shpreh edhe Figura 9.

Figura 9: Cikli i ndikimit mbi politikën përgjatë zhvillimit të politikës (burimi: përpunim i Co-PLAN)



Siç e tregon dhe figura më lart, cikli politik është një proces natyror përmes të cilit kalojnë nismat e projekteve, strategjive apo planifikimeve. Në varësi të interesit si dhe kontekstit në të cilin veprojmë, apo të kërkesave që rezultojnë nga konteksti i dhënë, zgjedhim se në cilën fazë ta nisim ndërhyrjen në politikë. Kjo ka mundësi ta përcaktojë edhe objektivin tonë politik, i cili mund të përfshijë një apo disa qëllime si pjesëmarrja aktive në strukturimin e politikës, ndikimi mbi vendimmarrjen, ndikimi mbi zbatimin, etj.


o Fazat dhe mjetet e cikleve ndikuese mbi politikën

Siç u theksua në krerët paraardhës, planifikimi është ndoshta një nga fazat më të rëndësishme të fushatave ndikuese. Tri nga pesë fazat e ciklit ndikues - *Identifikimi i çështjes për ndikim*, *Studimi i shkaqeve dhe pasojave* dhe *Strategjia e ndikimit* - kanë të bëjnë në radhë të parë me forma të ndryshme planifikimi të cilat mund të çojnë te një plan përfundimtar veprimi. Ky plan veprimi apo strategji e drejton më pas fushatën në fazën e katërt të saj - *Aksioni i organizuar* - dhe shërben si etalon kundrejt të cilit matim dhe vlerësojmë përfundimet në fazën e pestë - *Monitorimi dhe vlerësimi*. Le t'i shohim këto faza një e nga një.

Faza 1: Identifikimi i çështjes për ndikim

Ai që duket si hapi i parë i logjikshëm në çdo proces, në fakt është një nga detyrat më delikate në ngritjen e fushatës ndikuese. Kjo fazë fillon (por përfshin shumë më tepër se ka) me identifikimin e çështjes që do të trajtohet dhe të politikës mbi të cilën do të ushtrohet ndikimi. Kështu, një nga hapat e parë në çdo nismë ndikuese është identifikimi i objektivit të ndikimit që ka lidhje me ndonjë fushë problematike dhe politikë të veçantë. Në këtë proces, ka disa hapa të nevojshëm:

Figura 10: Faza identifikuese (përpunim i yni)



Identifikimi nis duke vështruar shportën e “problemeve” dhe duke zgjedhur atë që mund të trajtojmë më mirë. Në fakt, ndërhyrjet e nevojshme në një fushë të caktuar mund të jenë të panumërta. Por duke u përqendruar te ajo që është e mundur në varësi të interesave tona, ekspertizës dhe burimeve, si dhe duke përcaktuar një objektivi të qartë, të shprehur në objektiva konkrete, është mënyra më e mirë për të nisur një ndërhyrje konstruktive. Praktikuesit me përvojë që e kanë shndërruar ushtrimin e ndikimit në profesion, me grumbullimin e përvojës mund të zhvillojnë aftësinë që të merren me një mori çështjesh të ndryshme. Megjithatë, për ndikuesin fillestar, ajo çështje që e ka “për zemër” mund të shërbejë si fillim i mirë sepse siguron që ai të mbetet i motivuar gjatë gjithë procesit. Burimet duhen vlerësuar qysh në këtë fazë të parë. Këto nuk kanë të bëjnë vetëm me burimet financiare, por edhe me ekspertizën, sepse si fillestar

është e vështirë t'ia dalësh mbanë në fusha jashtë njohurive dhe aftësive që ke. Qëllimi duhet të jetë të përqendrohen përpjekjet në një qëllim thelbësor por njëherësh edhe realist.

Pasi është caktuar çështja, duhet identifikuar në terma të përgjithshme përmasa e politikës. Kjo bëhet me më tepër hollësi në fazën tjetër të kërkimeve, por është e rëndësishme që, qysh në fillim, të jemi të qartë për politikën në fjalë. Ndikimi mbi politikën ka të bëjë në radhë të parë me ndikimin për të ndryshuar politikën. Kështu, është thelbësore të identifikohet jo vetëm çështja me të cilën do të merremi, por edhe politikat që kanë të bëjnë me këtë çështje dhe me mënyrën sesi duam të ndikojmë mbi këto politika. Pastaj mund ta artikulojmë qartë ndikimin tonë në terma të një çështjeje e cila kërkon ndërhyrje.

Përfundimi më i rëndësishëm i kësaj faze duhet të jetë objektivi i ndikimit tonë, i shprehur në terma si të çështjes në fjalë, ashtu dhe të politikës që e rrethon. Objektivi duhet të jetë i qartë dhe i ndashëm lehtë në qëllime specifike. Për ndikuesin fillestar, sa më real të jetë objektivi, aq më të larta do të jenë mundësitë për sukses. Me më tepër përvojë dhe burime, mund të caktohen objektiva politike edhe më ambicioze.

Mjetet për fazën e *Identifikimit të çështjes për ndikim*:

Takimet e para: Këto sesione mund të ndihmojnë në harmonizimin e vlerave brenda grupit dhe për t'u siguruar që anëtarët janë të motivuar nga nevoja për të sjellë ndryshime lidhur me një çështje të dhënë ndikimi. Këto takime mund të fiksojnë çështjen dhe të theksojnë motivimin thelbësor të fushatës.

Grupi kërkimor i punës: Ky grup shqyrton gjendjen aktuale dhe rrethanat politike që shoqërojnë çështjen në vija të përgjithshme. Mund të nevojitet një farë kërkimi në këtë fazë. Ky grup është përgjegjës për dhënien e një raporti të qartë të gjendjes me aq hollësi sa duhen për të ngritur objektivin e ndikimit mbi politikën

Sesionet vetëvlerësuese: Një vlerësim realist i kapitalit të grupit ndikues ka shumë të ngjarë të jetë i domosdoshëm. Ky kapital përfshin aftësitë, ekspertizën, mundësitë dhe burimet përsa u përket financave dhe kohës në dispozicion. Në fund të fazës identifikuese, duhet të jetë gati një sasi e qartë e asaj që mund të investojë grupi ndikues në fushatë. Kjo shërben edhe për përcaktimin e një objektivi të qartë dhe për të shmangur dështimet e mëvonshme.

Faza 2: Kërkimi i shkaqeve dhe pasojave

Kjo fazë ofron themele të shëndosha për mbështetjen e strategjisë ndikuese jo vetëm mbi synime të dobishme por mbi fakte dhe mbi kontekstin. E ngritur mbi kërkimet e plota fillestare të fazës së parë, duhet të futemi në thelb të problemit për të zbuluar lidhjet mes shkaqeve dhe pasojave, të cilat përcaktojnë gjendjen aktuale si dhe politikën aktuale. Duke nisur me kërkime të zgjeruara dhe duke u futur më thellë në analizimin e atyre që gjejmë, qëllimi është të krijohet një bazë e fortë dhe kontekstuale e çështjes, të identifikohen sfidat më të mëdha dhe të theksohen pikat tona të forta e të dobëta. Kjo shkallë së pari duhet të vlerësojë shkallën e përpjekjeve të nevojshme për të ndjekur objektivin një ndikimi të caktuar mbi politikën. Ky vlerësim duhet të mbajë parasysh të paktën tri përmasat kryesore që u përgjigjen disa pyetjeve:

- **Konteksti:** Cila është konkretisht çështja në fjalë? Çfarë lidhje shkak-pasojë përcakton problemi që duam të trajtojmë? Cilat janë politikat e shkuara dhe të tashme që merren me këtë çështje? Cila është natyra e politikës dhe mjedisit të fushës në të cilën po operojmë?
- **Aktorët:** Cilët janë pjesëmarrësit kryesorë në çështje? Si ndikohet secili prej tyre nga gjendja aktuale? Si ndikohet secili prej tyre nga objektivi i ndikimit mbi politikën? Cila është audienca që synojmë? Cilën sjellje apo qëndrim duam të ndryshojmë dhe cila është mënyra më e mirë për ta bërë këtë? Si t'i qasemi më mirë audiencës?
- **Sfidat dhe potenciali:** Çfarë e pengon procesin politik që të lëvizë në drejtimin e dëshiruar prej nesh pra, cilat janë pengesat? Cilat janë sfidat me qëllim që propozimi ynë të pranohet? Cilat janë epërsitë tona? Ç'sistem levash kemi?

Ka shumë pyetje të tjera që kërkojnë përgjigje para nisjes së fushatës. Në fakt, strategjia ndikuese dhe hartimi i vetë fushatës duhet mbështetur mbi këto përgjigje. Figura 11 ofron një paraqitje grafike për këtë proces.

Veç studimit intensiv, kjo fazë kërkon edhe një analizë të thellë. Kjo përfshin vlerësimin kritik të të dhënave dhe reflektimin mbi skenarët e mundshëm. Disa nga mjetet më të përdorshme të analizës janë renditur më poshtë, ndërkohë që ekziston edhe një sasi e madhe informacioni lidhur me mënyrën e përdorimit të tyre në planifikim apo zbatim.

Ja edhe një këshillë: Në shumë raste, analistët bien viktimitë e qasjeve të ngurta dhe i nxjerrin rezultatet nga këto mjete analitike si të vërteta objektive mbi të cilat mbështesin vendimmarrjen e tyre. Është me rëndësi të mbahet parasysh se, si të gjitha mjetet e tjera, edhe këto kanë kufizimet e veta dhe përfundimet i duhen nënshtruar gjithnjë një procesi reflektimi kritik. Prandaj e këshillojmë ndikuesin fillestar t'u qaset këtyre mjeteve ashtu siç janë: mjete që mund të hedhin dritë mbi disa aspekte të realitetit që rrethon një çështje të caktuar, që duhen përdorur në mënyrë kritike dhe të kombinuara me mjete të tjera.

Një arsye tjetër për familjarizimin me këto mjete është se ato përdoren gjerësisht në analizën e politikës publike nga ligjvënësit ose vendimmarrësit. Shpesh vendimet nëse një politikë e caktuar duhet vënë në zbatim apo jo janë gjithnjë subjekt i këtyre analizave, përfundimet e të cilave përdoren më pas për të përligjur apo legjitimuar një politikë të caktuar. Prandaj, ndikuesit duhet të familjarizohen jo vetëm me këto mjete kyçe por edhe me mangësitë e tyre dhe me kritikizmin që shoqëron përdorimin e ngurtë të këtyre mjeteve. Në këtë mënyrë, ndikuesit mund të gjurmojnë edhe logjikën që qëndron në bazë të proceseve vendimmarrëse që rezultojnë në një politikë të caktuar, çka e bën më të lehtë ndryshimin apo kundërshtimin e saj përfundimtar.

Mjetet për fazën Studimi i shkaqeve dhe pasojave:

Analiza e pemës së problemeve: Ky është një nga mjetet më të përdorshme planifikuese. Ai e ndan problemin në copa të administrueshme dhe të përcaktuara. Në këtë mënyrë, lejon vendosjen e përparësive mes faktorëve dhe ndihmon në përqendrimin te objektivat. Në kontekstet sfiduese, ky mjet mund të ofrojë një pamje më të qartë të marrëdhënieve shkak-pasojë që përmban një problem i dhënë.

Analiza e pjesëmarrësve: Kjo përdoret gjerësisht për të përcaktuar se cilët janë ata që marrin apo kanë pjesë në një çështje të caktuar. Individët apo grupet që kanë mundësi të ndikojnë apo të ndikohen nga një veprim i propozuar identifikohen dhe renditen sipas ndikimit të tyre mbi veprimin dhe ndikimit të veprimit mbi ta. Kjo analizë është veçanërisht e dobishme në rrethana të zgjidhjes së konflikteve ose kur ndikon në një mjedis kur përplasen interesa të forta.

Analiza kosto-përfitim (AKP): Ky mjet paraqet një proces llogaritjeje dhe krahasimi mes përfitimeve dhe kostove për një politikë të caktuar. Qëllimi është të vlerësohet nëse një politikë sjell më tepër përfitime se kosto, do me thënë, nëse ia vlen apo jo të ndiqet. AKP-ja është një nga mjetet më të përdorshme për analizën politike por edhe një nga më të debatueshmit. Kritikohet sidomos për përdorimin që i bëhet në politikën mjedisore, politikën sociale ose politikën me ndikim të konsiderueshëm social për llogaritjen e gabuar të ndryshoreve si humbja e jetëve njerëzore apo dëmin në mjedis. Ndikuesit në fushat e drejtësisë sociale, të drejtave të njeriut apo çështjeve mjedisore duhet të familjarizohen veçanërisht me kritikizmin që shoqëron këtë mjet të përdorur shpesh për të legjitimuar politikën që synojnë të sfidojnë. I përdorur me korrektësi, AKP-ja mund të ndihmojë në planifikimin e fushatave ndikuese.

Analiza e skenarëve: Ky mjet përfshin një proces analizimi të ngjarjeve të mundshme në të ardhmen duke shqyrtuar përfundime të mundshme alternative. Ajo mund të shërbejë për planifikimin e skenarëve të ndryshëm qysh më herët, kur jemi ende në fazën kërkimore të fushatës ndikuese. Mund të ndihmojë në përvetësimin e sfidave dhe përgatitjen më mirë për to.

Faza 3: Strategjia e ndikimit

Qëllimi i kësaj faze është të mbledhë gjithë reflektimet, informacionet dhe analizat të dy fazave paraardhëse në një strategji ndikimi, e cila do të përdoret për të organizuar veprimin dhe për të ruajtur fokusin gjatë fushatës. Një strategji e mirë ndikuese duhet të synojë drejt objektivit të ndikimit të përcaktuar në fazën e parë dhe mund të ngrihet rreth të dhënave dhe analizave të zhvilluara në fazën e dytë.

- ✓ Një strategji ndikimi duhet të shërbejë së pari si tregues i qartë i asaj që përfaqëson dhe i asaj që synon të arrihet. Në këtë mënyrë, ajo duhet të përmbajë *të paktën një formulim të misionit, objektivat kyçe dhe synimet*.
- ✓ Së dyti, duhet të organizojë burimet dhe aftësitë në veprime reale në mënyrën më efektive të mundshme. Kjo përfshin zhvillimin e një llogaritjeje të hollësishme të *ekspertizës në dispozicion, të buxhetit dhe burimeve të tjera*.
- ✓ Së treti, strategjia e ndikimit duhet të shërbejë si udhërrëfyes për fazën tjetër të veprimit të organizuar, e cila nis kur të gjitha përgatitjet dhe planifikimet përkthehen në përpjekje. Në këtë mënyrë, ajo duhet të përmbajë *planet e veprimit*, qasjet dhe *mjetet* që do të përdoren.

Mjetet për fazën e Strategjisë së ndikimit:

Formulimi i misionit: Kjo shërben si bazë për profilin e përgjithshëm të fushatës ndikuese. Zakonisht merr formën e një deklaratë të përgjithshme mbi synimin dhe shërben për të udhëhequr veprimtaritë afatgjata të organizmave ndikues.

Objektivat: Objektivat e ndikimit duket t'u ngjasojnë formulimeve të orientuara nga synimi specifik që qëndron në thelb të veprimtarive të organizimit. Këto duhet të shërbejnë për të arritur misionin në tërësi. Si rregull, një hartim i mirë i objektivave duhet të ketë cilësitë SMART. SMART është shkurtesa për fjalët Specifike, të Matshme, të Arritshme, Realiste dhe të Trajtuar në kohë, të gjitha këto me shtesën e fjalëve "të Evidentuara" dhe "të Rivlerësuara" të përdorura së fundmi (SMARTER). Kështu, objektivat duhet të jenë të përcaktuara qartë, të kenë pamje realiste dhe të shoqërohen nga një program veprimtarish.

Synimet: Në varësi të objektivave, organizata mund të përcaktojë synime të ndryshme afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata. Këto synime ndihmojnë në organizimin e veprimeve dhe lehtësojnë vlerësimin e fushatës, duke matur arritjen e synimeve kundrejt një programi specifik.

Inventari i burimeve dhe buxheti: Inventari i burimeve mund të përfshijë të gjitha asetet e dukshme e të padukshme që do të përdorë organizata për të përmbushur misionin e vet. Një buxhet i kujdesshëm mund të përfshijë informacion të hollësishëm mbi burimet financiare dhe shpërndarjen e tyre sipas objektivave specifike. Këto ndihmojnë në përcaktimin e objektivave realiste dhe hartimin e planeve të veprimit që përputhen me aftësitë e ndikuesit apo organizatës.

Planet e veprimit: Planet e veprimit u ngjajnë planeve strategjike në shkallë më të vogël dhe shërbejnë për ta drejtuar ndikuesin në fazën e katërt të ciklit ndikues - aksioni i organizuar. Ka metoda të ndryshme për të hartuar plane veprimi. Organizata pa përvojë mund të mbajë parasysh që çdo objektivi t'i bashkëngjitë një plan të veçantë veprimi. Sa më i hollësishëm të jetë plani i veprimit, aq më e ulët është mundësia për ngatërresa në fazën tjetër. Planet e veprimit luajnë një rol kyç në sigurimin e përdorimit efikas të burimeve dhe janë veçanërisht të dobishme në menaxhimin e kohës.

Qasjet dhe mjetet: Kjo pjesë e strategjisë është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse përcakton natyrën e veprimit. Si ti qasesh një audience të caktuar, ç'loj veprimi të ndërmarrësh, cilat mjetet të përdorësh për të arritur sa më mirë synimet janë të gjitha pjesë e kësaj faze. Këto qasje dhe mjetet duhen harmonizuar me objektivat, synimet dhe burimet që kemi në dorë

Faza 4: Veprimi i organizuar

Faza e fundit dhe ndoshta më proaktivja e ciklit të ndikimit mbi politikën është Faza e aksionit të organizuar. Këtu të gjitha planifikimet dhe reflektimet përkthehen në veprime reale për të ndikuar një politikë të caktuar dhe për të sjellë ndryshimin. Pikërisht në këtë fazë bëhet thelbësore ndërthurja me ciklin politik.

Në pjesën e mëparshme përmendëm se nismat ndikuese mbi politikën mund ta kenë zanafillën në cilëndo fazë të ciklit politik. Prandaj është thelbësore të identifikohet pika e hyrjes qysh në fillim. Faza e ciklit politik ku hyn në veprim ndikimi ynë ndikon së tepërmi mundësitë për sukses të qasjeve dhe mjeteve të ndryshme. Me fjalë të tjera, ndikimi mund të nisë në cilëndo fazë por qasjet apo rrjedhat e veprimeve duhen përputhur me fazën specifike të politikës ku po ndërhyjmë. Për shembull, studimet e zgjeruara dhe botimet mund të vlejnjë në fazën e hartimit të axhendës apo formulimit të politikës, por nuk janë qasje të mira në zbatimin e politikës apo vlerësimin e politikës. Ose, për të dhënë një shembull tjetër, faza e vendimmarrjes në ciklin politik mund të ndikohet më mirë përmes lobimit sesa përmes publikimeve.

Kështu, qasja dhe mjetet e zgjedhura i japin formën aksionit të organizuar por përcaktojnë në shkallë të gjerë edhe mundësitë tona për sukses. Përshtatja e qasjes së duhur apo zgjedhja e mjeteve të përshtatshme mund të jenë çelësi për të arritur objektivat tona. Mjetet ndikuese ndryshojnë shumë për nga lloji dhe shkalla e shtrirjes. Për shembull, strategjitë e komunikimit dhe ngritja e përkrahjes kanë shkallë të gjerë dhe përqendrohen te sigurimi i mbështetjes nga publiku i zakonshëm. Këto mund të jenë mjetet e suksesshme në ngritjen e ndërgjegjësimit për ta futur një çështje në axhendën publike. Nga ana tjetër, planet për lobim dhe artikujt politikë zakonisht synojnë ligjvënësit dhe vendimmarrësit, çka i bën ato të dobishme në negociata, votime apo vendimmarrje në përgjithësi.

Ka mjetet të panumërta që mund t'i japin formë aksionit të organizuar. Më poshtë po renditim disa mjetet që mund të përdoren në faza të veçanta të ciklit politik.

Mjete për fazën e Aksionit të organizuar:

Kur të ndërhysh në përcaktimin e axhendës: Në këtë fazë, qëllimi kryesor i ndikuesve mbi politikën është ta fusin çështjen e tyre në axhendën e individëve, grupeve apo institucioneve që kanë fuqi të kryejnë ndryshime. Një fushatë mediatike e hartuar me kujdes shpesh ndihmon në bërjen publike të çështjes. Shumë ndikues zgjedhin edhe mjetet më agresive si organizimi i protestave, grumbullimeve apo marshimeve. Përdoren edhe grevat, sidomos nga individë ose grupe me pak pushtet dhe burime, për të tërhequr vëmendjen e publikut dhe ligjvënësve. Artikujt studimorë dhe shkrimet politike mund të ndihmojnë në nxjerrjen në pah të një çështjeje të caktuar që ka nevojë për ndryshime politike.

Kur të ndërhysh në formulimin e politikës: Kjo fazë vjen kur problemi është strukturuar qartë dhe janë zhvilluar propozimet dhe zgjidhjet politike. Ka dy përmasa të mundshme ku ndikuesi mund të provojë të ushtrojë ndikimin: (i) fusha e ekspertizës dhe (ii) ngritja e konsensusit. Një shembull i mjetit ndikues në këtë fazë është ekspertiza ligjore, e cila mund të përdoret për të ndikuar mbi mënyrën e formësimit të ligjit.

Kur të ndërhysh në vendimmarrje: Kjo është faza kur procesi vendimmarrës largohet nga debatet fillestare dhe bëhet më tepër formal. Zakonisht përfshin votimin lidhur me një politikë të caktuar. Shkrimet studimore apo politike mund të jenë më pak të dobishme në këtë fazë sepse ndikuesi nuk përballet më me komisione vlerësuese por me politikanë dhe ligjvënës. Ngritja e rrjeteve apo lobimi i organizuar mund të përdoren për të ndikuar vendimet në këtë fazë.

Kur të ndërhysh në zbatimin e politikës: Kjo fazë ka të bëjë me zbatimin e një politike të caktuar dhe me pasojat e këtij zbatimi. Ndikimet në këtë fazë shpesh synojnë të ndikojnë mbi zbatimin që ai të sjellë përfundimet e dëshiruara. Një mjet interesant i përdorur për këtë qëllim është analiza e vlerësimit të ndikimit, e cila diskuton zbatimin për të vlerësuar ndikimin e një politike të dhënë mbi një grup, mbi shoqërinë si një të tërë, mbi mjedisin, etj. Në rast ndikimesh negative, ndikuesit shpesh i bëjnë publike përfundimet duke shpresuar që të fitojnë mbështetje për të ndaluar apo ndryshuar zbatimin e saj.

Kur të ndërhysh në vlerësimin e politikës: Fushatat monitoruese janë shpesh mjetet më të përhapura politike vitet e fundit. Ato zakonisht monitorojnë arritjet e një politike të caktuar nën dritën e objektivave fillestare dhe përcaktojnë potencialin për përmirësime.

Faza 5: Monitorimi dhe vlerësimi

Njësoj si cikli politik, edhe ciklet ndikuese rezervojnë një fazë për monitorim dhe vlerësim. Në këtë fazë përparimi monitorohet periodikisht dhe maten rezultatet krahasuar me objektivin e ndikimit, synimet dhe strategjinë e tij. Monitorimi dhe vlerësimi është ndoshta faza më e lënë pas dore në shumë nisma ndikuese. Shpesh kjo vjen për shkak të faktit se rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit perceptohen si qëllime, jo si mjete. Në të vërtetë, ky proces vetëvlerësimi duhet të reflektohet me sy kritik dhe të kapen shenjat për përmirësimet e nevojshme. Kjo fazë mund të shërbejë për të përshtatur fushatën tonë ndikuese dhe për të lënë pas praktikat joproduktive. Mund të ndihmojë edhe për të planifikuar ndikime më të mira në të ardhmen.

Mjete për fazën Monitorim dhe vlerësim:

Një plan monitorues dhe vlerësues: Një plan efikas monitorues dhe vlerësues kërkohet për të përcaktuar se sa mirë i ka përmbushur objektivat e saj fushata e ndikimit. Monitorimi periodik sipas një programi të caktuar shmang shpenzimin e burimeve dhe siguron transparencë të veprimeve. Ky plan e shoqëron ushtrimin e ndikimit gjatë gjithë ciklit. Për këtë arsye, ky plan hartohet qysh në fillim të nismës.

Treguesit: Identifikimi i treguesve për të matur përparimin kundrejt objektivave të ndikimit mund të jetë një nga detyrat më të vështira të fazës monitoruese dhe vlerësuese. Përpunimi i treguesve SMART është diçka që vjen bashkë me përvojën dhe ndikuesi fillestar nuk duhet të përpiqet të ndërtojë lista të ngatërruara me tregues të panumërt. Në vend të kësaj, është e rëndësishme të mbajë tregues të thjeshtë, funksionalë e të matshëm.

Struktura për mbledhjen e të dhënave: Monitorimi dhe vlerësimi janë procese pasqyruese sepse kanë nevojë vazhdimisht për të dhëna të mbledhura në mënyrë periodike dhe me përgjegjësi. Për këtë arsye, mund të hartohet një strukturë që të japë hollësisht si dhe kur duhet të ndodhë mbledhja e të dhënave, kur dhe si do të grumbullohen e procedohen këto të dhëna dhe kush është përgjegjës për mbledhjen e tyre and processed, as well as who is responsible for the collection and analysis.

Mjetet e mësipërme që ilustronë çdo fazë duhet të përdoren në mënyrë kritike dhe krijuese. Shumë prej tyre mund të përdoren në mënyra të ndryshme dhe të shfrytëzohen në faza të ndryshme. Për shembull, një plan monitorimi dhe vlerësimi funksionon më mirë kur hartohet qysh në fillim dhe jo në fazën përmbyllëse. Njësoj si me ciklin politik, modeli me faza i paraqitur gjatë këtij kreu nuk duhet trajtuar si i ngurtë. Më tepër duhet marrë si një udhërrëfyes për të planifikuar strategji të suksesshme ndikuese.

VI. Shënime përmbyllëse

Ky udhërrëfyes njohës synon të lehtësojë hapat e para të ndikuesit fillestar mbi politikëbërjen. Ai shërben si një hyrje në ndikimin politik si dhe mjedisin politikëbërës në Shqipëri.

Në këtë udhërrëfyes janë përmendur qasje të ndryshme ndikuese dhe mjete, për të ilustruar skenarë të ndryshëm dhe këndvështrime të ndryshme të ndikimit mbi politikën publike. Megjithatë, ndikuesi fillestar duhet të mbajë ndërmend se **ndikimi më i mirë është ndikimi i përshtatur nga vetë ai**. Siç do ta zbuloni së shpejti, kur kërkon të bësh ndryshime, konteksti është gjithçka dhe modelet e gatshme rrallë hyjnë në punë nëse nuk përshtaten me kontekstin në fjalë.

Për këtë arsye, njohuritë bazë mbi metodat e ndryshme dhe shembujt e ndryshëm në këtë udhërrëfyes, duhet ta ndihmojnë ndikuesin fillestar të formësojë qasjen e tij individuale për ushtrimin e ndikimit. Kjo përsoset me kalimin e kohës dhe fillimisht mjetet e strategjitë standarde mund të jenë shumë të dobishme. Por meqë aktorët, mjedisi politik dhe kultura ndryshojnë jashtëzakonisht nga një vend në tjetrin, një qasje e suksesshme ndikuese do të ishte ajo që shkon përtej modeleve standard dhe i ka rrënjët në praktikat lokale. Kjo nuk do të thotë se ndikuesit duhet të përdorin të njëjtat praktika si ato që synojnë të ndryshojnë, me qëllim arritjen e rezultateve. Më tepër do të thotë se një njohje e tërësishme e aktorëve dhe metodave të përdorura në sistemin politikëbërës të një vendi është hapi i parë për ta përmirësuar këtë sistem.

Shpresojmë që “think tank”-et, organizatat e shoqërisë civile, qendrat kërkimore dhe individët apo grupet vullnetare ta përdorin këtë udhërrëfyes si një hap të parë drejt ndikimit mbi politikën. Në përpjekje për të ushtruar ndikim mbi politikëbërjen, ndikuesit po ashtu ushqejnë edhe angazhimin aktiv të shoqërisë civile shqiptare në vendimet që i japin formë jetës publike, çka është në vetvete një synim fisnik për cilëndo nismë.

Referencat



- Anderson, J. E. (2003) *Public Policymaking: An introduction*. Boston: Houghton Mifflin Company
- Anderson, J. E. (2011) *Public Policymaking: An introduction*. Seventh Edition. Boston: Houghton Mifflin Company
- Bechev, D. (2012) *The periphery of the periphery: The Western Balkans and the euro crisis*, London: European Council on Foreign Relations (ECFR)
- Beder, S. (2002) 'Agenda Setting for Environmental Protection Policies', in S. Kerr et al. (eds.) *Green Governance: From Periphery to Power*, Lincoln University, Christchurch
- Bridgman P. and Davis, G. (1998) *Australian Policy Handbook*, Sydney: Allen and Unwin
- Carden, F. (2005) *Using Research in Public Policy Processes*. Paper presented at International Conference on Research, Public Policy and Asian Public Policy Schools 2005. Available online: <http://www.idrc.ca/uploads/user-S/11132677781FredCarden.doc>
- Carden, F. (2009) *Knowledge to Policy: Making the Most of Development Research*. Ottawa: International Development Research Centre and Sage Publications. Available online: <http://web.idrc.ca/openebooks/417-8/>
- Clay, E. and B. Schaffer (1984) *Room for Manoeuvre: An Exploration of Public Policy in Agricultural and Rural Development*. London: Heinemann
- Constitution of the Republic of Albania
- Council of the European Union (2006) *Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the One Part, and the Republic of Albania, of the Other Part*. Brussels, 22 May 2006
- Council of the European Union (2010) *Visa Liberalisation for Albania and Bosnia and Herzegovina*, Press Release, issued: Brussels, 8 November 2010.
- Council of Ministers on DSDC. Available online: http://dscd.gov.al/dscd/Department_of_Strategy_and_Donor_Coordination_5_2.php
- Dhima, S. (2011) *Albania's Journey into the Bologna Process: Europeanizing Higher Education Policies and the role of Epistemic Communities*, [master thesis], The Hague: Erasmus International Institute of Social Studies, Available Online: http://oaithesis.eur.nl/ir/repub/asset/10825/-_BA_7552_-_Sibora_Dhima_RP.pdf
- Emergency Economic Stabilization Act 2008 (US Congress) Available online: <http://www.gpo.gov/fdsys/pkg/PLAW-110publ343/html/PLAW-110publ343.htm>
- Greenpeace International, *About Greenpeace* Available online: <http://www.greenpeace.org/international/en/about>
- Howlett, M. and M. Ramesh (1995) *Studying Public Policy: Policy Cycles and Policy Subsystems*. Toronto: Oxford University Press.
- INSTAT (2009) *Results on Structural Survey of Economic Enterprises*, Tirana: INSTAT, Available online: http://www.instat.gov.al/media/33018/asn_2009.pdf
- INSTAT (2012) *Foreign Trade January 2012*, Tirana: INSTAT, Available online: http://www.instat.gov.al/media/103906/tregtia_e_jashtme__janar_2012.pdf
- Iyengar, S and Kinder, D (1987) *News That Matters: Television and American Opinion*. Chicago, IL: University of Chicago Press.
- Iyengar, S (1990) "The accessibility bias in politics: Television news and public opinion". *International Journal of Public Opinion Research* 2: 1–15.
- Jarvis, C. (2000) 'The Rise and Fall of Albania's Pyramid Schemes', *Finance and Development*, 37(1) Available online: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/fandd/2000/03/jarvis.htm>
- Kingdon, J. W. (1995) *Agendas, Alternatives and Public Policies*, 2nd ed., New York: Harper Collins
- Kondaj, R. (2002) 'Management of Refugee Crisis in Albania during the 1999 Kosovo Conflict', *Public Health* 43(2): 190-194
- Krafchik, W. "Can civil society add value to budget decision-making? A description of civil society budget work", *International Budget Project*. Available online: <http://www.internationalbudget.org/resources/library/civilsociety.pdf>

Law Nr. 9830, date 28.04.2005, On the Right to Authorship and other Related Rights, Available online: tatime.gov.al/gdt/DF_DocumentViewer.aspx?id=36689ae5-c9a7-4321-88bb-318e48a9aeb4

Law Nr. 10033, date 11.12.2008, On Gambling Games, Amended, Available online: http://tatime.gov.al/gdt/DF_DocumentViewer.aspx?id=f9eb6a49-7a49-401d-9a22-938f5002f054

Likmeta, B. (2012) 'Albania Slashes Waste Import List' Balkan Insight, Available online: <http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-slashes-waste-import-list>

Lowi, T. J. (1972). "Four Systems of Policy, Politics, and Choice", *Public Administration Review* (American Society for Public Administration) 33 (3): 298–310.

McCombs, M. and Shaw, D. (1972) "The agenda-setting function of mass media", *Public Opinion Quarterly*, 36, 176-185.

MLSIEO (2007), Strategy for Social Inclusion 2007-2013, Available online: www.mpcs.gov.al/images/stories/ministria/downloads/strategji-standarte/strategji_perfshirje_sociale2007-2013.zip

MoF (2008) Sectoral Strategy of Public Finances 2008 – 2013, Available online: http://www.dsd.gov.al/dsd/pub/strategjia_financave_publike_158_1.pdf

Muço, M. and Ö. Sjöberg (2005) 'A Chequered History: Political Culture and Conflict in Albanian Economic Reform', in M. Lundahl and M. L. Wyzan (eds.), *The Political Economy of Reform Failure*, NY: Routledge

Nohlen, D & Stöver, P (2010) *Elections in Europe: A data handbook*, Baden-Baden: Nomos

Ruli, G. (2012) Our Policies: much more realistic and well designed than the models that would have naturally been adopted by the Socialist Party. Declaration. Available online: <http://www.mbumk.gov.al/?p=3345>

Start, D. and I. Hovland (2004) *Tools for Policy Impact: A Handbook for Researchers*. London: Overseas Development Institute.

UNDP (2010) *Regional Disparities in Albania*, Tirana: Integrated Support for Decentralization Project <http://intra.undp.org.al/ext/elib/download/?id=1124&name=Regional%20Disparities%20Analysis.pdf>

World Bank (2006) *Albania: Restructuring Public Expenditure to Sustain Growth: A Public Expenditure and Institutional Review*. (Volume 1: Overview and Policy Options), World Bank: Poverty Reduction and Economic Management Unit, Available online: http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2007/03/20/000020953_20070320142304/Rendered/PDF/364530v1.pdf

Young, E. and L. Quinn (2012) *Making Research Evidence Matter: A Guide to Policy Advocacy in Transition Countries*. Budapest: Open Society Foundations

